

Procesverbal

Nga Mbledhja VI (e gjashtë) e rregullt e Kuvendit Komunal në Dragash , e mbajtur më datë: 28.06.2024

Rend Dite

1. Miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027.
2. Eventuale

Arijeta Skeraj: Përshëndetje për të gjithë! Mirë se keni ardhë në seancën e gjashtë të rregullt për vitin 2024! Materialin besoj që e keni pranuar të gjithë. Të nderuar asambleistë, para se të fillojmë me rendin e ditës, më lejoni që t'ju njoftoj se, pas gjendjes së krijuar nga vërshimet në Komunën tonë, bashkë me kryetarin e Komunës dhe një pjesë të Kabinetit të tij, në emër të Asamblesë Komunale kam vizituar fshatrat e prekura nga vërshimet, ku i kam parë nga afër dëmet e mëdha që kanë shkaktuar këto vërshime, fatmirësisht pa pasoja në njerëz. Gjithashtu, kam marrë pjesë në mbledhjen e djeshme të thirrur nga kryetari i Komunës, ku është formuar edhe Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore, i cili do të nis punën në terren për të bërë vlerësimin e të gjitha dëmeve që janë shkaktuar në ekonomi familjare, biznese, sipërfaqe bujqësore dhe infrastrukturë publike. Bazuar në dispozitat ligjore, Raporti përfundimtar që do ta hartojë ky Komision pas përfundimit të punës në terren dhe vlerësimit të dëmeve, duhet të shqyrtohet dhe të miratohet nga Asambleja Komunale, para procedimit të mëtutjeshëm për në autoritetet kompetente qendrore. Andaj, besoj se si organi më i lartë vendimmarrës dhe përfaqësues të qytetarëve, do të jemi bashkëpunues në këtë drejtim, në mënyrë që t'u dalim në krah qytetarëve të cilët kanë pësuar nga këto vërshime. Ju faleminderit! Para se ta hedhim në votim rendin e ditës, kryetari e ka kërkuar fjalën.

Bexhet Xheladini: E nderuar kryesuese, zv/kryesues, të nderuar asambleistë, përfaqësues të OSBE-së, media, ju përshëndes dhe ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë mbledhje të Asamblesë! Kryesuesja e dha një informatë të përgjithshme për gjendjen pas vërshimeve. Edhe unë pata ndërmend me thënë diçka, por po e lëmë në pikën e ndryshme, sigurisht që do të jap një informatë më të saktë dhe më të gjatë, dhe pastaj mujm edhe të debatojmë edhe në pikën eventuale për vërshimet, nëse keni nevojë. Faleminderit!

Shpetim Hajredini: Faleminderit, e nderuar kryesuese! Përshëndetje, i nderuar ekzekutiv, koleg asambleistë, qytetarë të nderuar të Dragashit! Unë pata ta bëj një propozim, si shef i Grupit të PDK-së, por së pari, si gjithmonë, unë jam liberal edhe kam qef me e marrë një mendim të kryetarit dhe të juajin, znj.kryesuese, që diskutimin ta kemi në një pikë të veçantë dhe të mos e lëmë në eventuale. Për çështjen

e vërshimeve që kanë ndodhë nëpër fshatra. Gjatë diskutimit në atë pikë, të shohim dhe të diskutojmë edhe për Komisionin të cilin e keni formuar, dhe për çështje tjera të cilat janë të ndjeshme dhe duhet diskutuar për këtë fatkeqësi që na ndodhi dy ditë më parë. Atëherë, të pres përgjigje, apo ta bëj si propozim që ta kemi pikë tjetër të rendit të ditës? Atëherë po e bëj propozim që ta kemi pikë të rendit të ditës! Faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Më vjen shumë keq për fatkeqësitë natyrore që kanë ndodhur në komunën tonë. Komiteti për komunitete dje ka marrë vendim që çështjen e fatkeqësive natyrore ta trajtojë në një pikë të veçantë. Nuk e di nëse ju kanë informuar për këtë. Të formohen komisione dhe gjithçka që është e nevojshme për ti ndihmuar qytetarët tanë në atë pikë. Kërkoj që ajo të futet si pikë në rend dite dhe të jetë e para, sepse edhe ajo është prioritare dhe pika e KAB-it mund të jetë e dyta.

Nexhat Selaj: Faleminderit, kryesuese! Përshëndetje kryetar, kolegë, media! Pavarësisht keqardhjes që na ndodhi, edhe unë jam i mendimit se në pikë të parë të rendit të ditës të jetë fatkeqësia, dhe kisha kërkuar nga ekzekutivi dhe asambleistët që të jetë si pikë e rendit të ditës një fondacion i ndarë për rrezikshmëritë. Këtu ndoshta mund të flasim edhe të eventuale pak më tepër, por kërkesa ime është që të kemi një fondacion të veçantë, duke marrë parasysh kushtet, terrenin, lartësitë mbidetare, reshjet atmosferike, e kështu me radhë. Një kërkesë tjetër, paksa e imja, paksa e qytetarëve të Komunës së Dragashit, pikërisht të qytetarëve të Dragashit, wshtw Qarkorja e rrugës, e cila vitin që shkoi na wshtw mbyllur për 24 orë për një muaj të plotë. Kryetar, unë po besoj se ju keni kontaktuar me bizneset – apo jo, nuk po e di, por po besoj se ndoshta po – është kërkesë e bizneseve të Komunës së Dragashit, pikërisht e qytetarëve të Dragashit, që rrugë në këtë kohë e fluksit të bashkatdhetarëve që vijnë, mos të bllokohet 24 orë. Të jepet një mundësi që brenda këtij 24 orëshi të gjendet një kohë për qarkullim. Në bisedimet të cilat kam has me bizneset dhe qytetarët, një kohë e favorshme është që të paktën nga ora 07:00 – 18:00 të është e bllokuar rruga, kurse pas orës 18:00 deri në orën 07:00 nesër në mëngjes, rruga të jetë e qarkullueshme, se po shkakton shumë probleme, jo tash vetëm në grumbullim të makinave, rruga e keqe, por edhe në humbjen e kohës. Kështu që unë dje të kam kërkuar, ndoshta ka qenë e vonë kjo pa asnjë arsye, tash i kemi edhe dy-tri javë, presim edhe katër të kthehet, ishalla vijnë shëndoshë e mirë, të mos e bllokojmë qytetin e Dragashit. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Unë në fillim propozova që do të debatohet për fatkeqësitë elementare që kanë ndodhë si pasojë e vërshimeve. Unë propozoj që Asambleja Komunale së pari të fillojë me KAB-in si pikë të parë, pika e dytë të jetë vërshimet, pika e tretë e ndryshme. Ndërsa, sa i përket kësaj rruges unazore, ju ma bëni një kërkesë mua si kryetar, me bizneset që kanë kërkuar, me nënshkrime edhe atë orarin. Ne e kemi në KKSB mbledhjen, e debatojmë aty edhe e marrim vendimin.

Uran Halimi: Faleminderit, znj.kryesuese! Përshëndetje për ju të pranishëm! Ne si Grup Parlamentar i LVV-së, patjetër që e mbështesim propozimin që pika e parë e rendit të ditës të jetë pika që përfshin vërshimet. Arsyeja është se ne jemi thjesht të ardhur këtu prej qytetarëve dhe patjetër që duhet t'u rrimë afër qytetarëve, meqenëse janë vërshime dhe është gjendja pak a shumë alarmante në disa vende të trevës sonë. Shpreh rastin t'i ngushëlloj ato familje, ata qytetarë të cilët i ka prek ky vërshim. Është mirë që në momente të dhura t'u qëndrojmë afër qytetarëve. Faleminderit shumë!

Arijeta Skeraj: Atëherë, me propozimin që e dha shefi i GP të PDK-së, z.Sejdilar, z.Selaj dhe z.Uran Halimi, propozimi duhet të futet si pikë e rendit të ditës. Pika e parë e rendit të ditës do të jetë miratimi i KAB-it, pika e dytë do të jetë diskutimi për vërshimet që kanë ndodhur, dhe pika e tretë do të jetë eventuale.

Driton Ademi: Përshëndetje për të gjithë! Kryesuese, unë me sa e di, ne jemi vetë asambleistë këtu, edhe mundim me vendos a mundim me e qit pikë të parë të rendit të ditës propozimin e GP të PDK-së, apo me e qit KAB-in. Kështu që, nuk është ndonjë problem shumë i madh nëse e qesim. Vendos Asambleja, a e qesim si pikë të parë apo pikë të dytë. Edhe me ligje kemi të drejtë që munemi me e qit, se e kemi edhe ma urgjente, që mundim me e qit si pikë të parë të rendit të ditës. Kështu që, propozimi i Shpetimit është për me e vendos si pikë të parë të rendit të ditës. Tani e qesish propozimin e qeverisjes. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Propozimi i Shpetimit ishte në kuadër të kryetarit edhe të kryesueses. Unë e lus edhe një herë Shpetim Hajredinin që ta marrë fjalën! Pika e parë e rendit të ditës do të jetë miratimi i KAB-it dhe pika e dytë ka me qenë diskutimi për vërshimet. Çka do me thënë në qoftë se s'është, si e para si e dyta, unë rregulloren time e kqyri. Shpetimi veç për një sqarim qysh e tha, le ta dëgjojë Driton Ademi.

Shpetim Hajredini: Atëherë, patjetër që janë edhe procesverbalet dhe videot, po edhe po që se nuk do të ishin këto, unë nuk jam njeri që i ha fjalët. Prandaj, unë nuk kërkova që të jetë në pikë të parë të rendit të ditës, kërkova që të jetë si pikë e veçantë e diskutimit, pas KAB-it. Por, tash sido që të vendosin asambleistët, unë jam pro. Me rëndësi është që ne të diskutojmë sot edhe të marrim vendimin e duhur për qytetarët. Tjerat për mu nuk prishin punë. Kjo ka qenë ajo që unë e thashë. Faleminderit!

Arijeta Skeraj! Faleminderit! E qesim në votim! Miratimi i KAB 2025-2027; propozimet që u dhanë nga të gjithë, diskutimi për vërshimet që kanë ndodhur në Komunën tonë; dhe pika e tretë është eventuale. Kështu është pro këtij rendi të ditës? A ka kundër? Abstenim? Me 24 vota pro, zeri kundër dhe zero abstenim, miratohet rendi i ditës. Fillojmë me pikën e parë: Miratimi i KAB 2025-2027.

Qamil Kolloni: Përshëndetje për të gjithë! Përshëndetje kryetar, përshëndetje kryesuese! Ju delegatë, mysafirë dhe të gjithë pjesëmarrësit tjerë! Të nderuar delegatë, Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Dragashit është conform Kornzizës Afatmesme të Shpenzimeve e cila del nga ligji prej

Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, si pjesë përbërëse e KASH-it. Pra, Qeveria e Kosovës në kuadër të saj, komunat i konsideron si njëri shpenzuese buxhetore. Gjithashtu, për vitin 2025-2027, me Qarkoren e parë Buxhetore, Komuna e Dragashit ka përpiluar KAB-in 2025-2027. Sipas analizës të cilën i kemi bërë, nga Qarkorja e parë Buxhetore na dalin këto të dhëna: Komuna e Dragashit nga Granti i Përgjithshëm ka 7,135,380 euro; nga Granti Specifik i Arsimit ka 3,705,015 euro; nga Granti Specifik i Shëndetësisë ka 1,480,765 euro; dhe nga të Hyrat Vetanake ka 551,054 euro. Gjegjesisht, buxheti i përgjithshëm i Komunës së Dragashit për vitin 2025 ka një rritje prej 8%, në krahasim prej vitit 2024, dhe përfshin shumën e përgjithshme 12,872,214 euro. I gjithë ky buxhet është ndarë në programe për secilin drejtorat, por në përgjithësi ndahet në këto katër destinime të veçanta: Për Paga dhe Mëditje kemi 5,844,000 euro; Mallra dhe Shërbime kemi 1,513,000 euro; Shpenzime Komunale kemi 400,000 euro; dhe Subvencione kemi 400,000 euro. Nga e tëra kjo që mund të shihni, kanë ndryshime substanciale subvencionet që kanë një rritje, gjithashtu edhe shpenzimet komunale. Në përgjithësi, buxheti ka një rritje totale. Ju si delegatë do të pyetni se pse janë këto rritje. Investimet kapitale të viteve tjera, të cilat janë bërë në vazhdimësi, kanë dhënë efektet e veta pozitive, ku jemi të detyruar që të krijojmë edhe shpenzime shtesë. Gjithashtu, edhe kemi kontraktuar kompani për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të qytetit të Dragashit dhe janë duke u bërë një varg punë tjerash. Mirëpo, në KAB – duke e pas parasysh që janë bërë investime shumë të mira, të cilat gjenerojnë edhe vende të reja të punës – kemi paraparë edhe shtimin e numrit të punëtorëve. Si rrjedhojë e kësaj - nuk do të thotë se Ministria do ta miratojë kërkesën tonë – mirëpo nga investimet kapitale të cilat janë bërë, është si rrjedhojë që duhet të angazhojmë staf shtesë me punësime. E para kemi të bëjmë me regjistrimin e Muzeut Etnografik. E dyta, presim shumë shpejt gjatë këtij viti, që ta vëmë në funksion stadiumin e qytetit në Komunën e Dragashit, ku kemi paraparë që duhet së paku tre punëtorë të angazhohen për mirëmbajtjen dhe funksionalizimin e tij. Gjithashtu, presim këtë vit që – pavarësisht rrjedhave se si kanë ndodhë – që ta funksionalizojmë edhe stadiumin në fshatin Blaç, dhe gjithashtu edhe kemi paraparë dy punëtorë. Njëkohësisht kemi paraparë që t'i kryejmë edhe investimet në stadiumin e fshatit Plavë dhe atje ta angazhojmë edhe një mirëmbajtës. Këto investime prapë kanë afektue këtu. Gjithashtu, me Planin e arsimit – që nuk dua ta hyj ndoshta detajisht – por duhet ta dini se përmes investimeve dhe përmes hapjes së çerdheve me bazë në komunitet, do të bëhet angazhimi edhe i një numri shtesë të stafit në këto vende të punës. Me Qarkoren buxhetore, në arsim kemi pas disa shkurtime të vendeve të punës. Mirëpo, ne kemi shpresuar – kemi bërë kërkesën që të rishikohet ajo – mos ka ndodhë ndonjë gabim teknik, për arsye se buxheti nuk na është shkurtue, na janë shkurtue vetëm vendet e punës. Po shkojmë me i lexue një nga një:

1. Ndërtimi i Impiantit për pastrimin dhe filtrimin e ujit në Lumin e Radeshës, janë paraparë mjete për vitin 2025, 382,000 euro dhe 230 mijë euro kanë qenë të parapara për vitin 2024;

2. Ndërtimi i rrugëve në qytezën e Dragashit, Rruga “Sheshi i Dëshmorëve” dhe Rruga Unazore në Dragash - 105,935 euro për vitin 2025;
3. Kubëzimi i rrugëve te varrezat në fshatin Zaplluxhe, mahallët Rrenak, Tumqinë dhe mahalla te Xhamia – 100,000 euro për vitin 2025;
4. Kubëzimi i rrugëve “Livadhi i Begit” dhe Kodrat, dhe hapja e rrugës te Ura e Hoxhës në fshatin Blaç – 22,000 euro;
5. Ndërtimi i parkut në Rrugën “Skender”, Mahalla Prifte në fshatin Blaç – 50,000 euro;
6. Rregullimi i ujëmbledhësit dhe i kanalizimit në vendin “Gjybra e Pashës” në Blaç – 50,000 euro;
7. Ndërtimi i parkut dhe këndi i lojërave për fëmijë te Xhamia, dhe rregullimi i rrethojës së parkut tek Mahalla e Epërme e fshatit Blaç – 300,000 euro;
8. Kubëzimi i rrugëve në Rrugën “Luftëtari i Lirisë”, Rruga “Zgatar” dhe Rruga e Imamajve, ndërtimi i murit mbrojtës Rruga “Danaj” dhe rregullimi i parkut në qendër të fshatit Bresanë, për shpronësim – 271,939 euro (pra, disa projekte janë të përmbledhura në një);
9. Kubëzimi i rrugëve në fshatin Kuklibeg – 50,000 euro;
10. Ndriçimi publik në qendër të fshatit Kuklibeg – 30,000 euro;
11. Ndërtimi i murit mbrojtës në fshatin Kuk – 7,000 euro;
12. Kubëzimi në rrugët “Samidin Emini” dhe “Shelqja e Drugës” në fshatin Kuk - 87,118 euro;
13. Hapja dhe trasimi i rrugës Kuk – Kosavë – 15,000 euro;
14. Kubëzimi i rrugës qendrore në fshatin Buzëz – 69,000 euro;
15. Hapja e kanalit dhe rregullimi i ulësve dhe trotuarit deri në Mejdan në fshatin Kosavë – 97,555 euro;
16. Ndërtimi i murit mbrojtës te Rruga e Xhamisë në fshatin Kosavë – 33,000 euro;
17. Asfaltimi i rrugës Kapre – Rrenc – 200,000 euro;
18. Ndërtimi i kanalizimit dhe ujësjellësit në fshatin Kapre – 40,000 euro;
19. Kubëzimi dhe ndërtimi i murit mbrojtës në rrugët “Kuji i Mullinit” dhe “Prroni i Serdarit” në fshatin Zgatar – 90,000 euro;
20. Ndërtimi i kanalizimit dhe kubëzimi në rrugën Rrugën “Ograde” në fshatin Brrut – 7,000 euro;
21. Ndriçimi publik në qendër të fshatit Brrut - 2,000 euro;
22. Hapja e rrugës te Likeni në fushën e fshatit Brrut – 40,000 euro;
23. Ndërtimi i rezervuarit të ujit në vendin “Kroi i Madh” në fshatin Bellobrad – 25,000 euro;
24. Kubëzimi i rrugëve në fshatin Bellobrad 70,000 euro;
25. Kubëzimi i rrugëve në rrugën e xhamisë, ndërtimi i murit mbrojtës në Qollopek dhe kanalizimi nga Lugu i Pulës në fshatin Zym – 70,000 euro;
26. Ndërtimi i impiantit për ujërat e zeza në Rrugën e Mullinit në fshatin Brezne – 330,000 euro;

27. Kubëzimi i rrugëve “Pirkuqi”, “Kroi i Dhive” dhe “ Hani i Llopushnikut” në fshatin Brezne – 45,645 euro;
28. Kubëzimi i rrugëve “Adem Berisha”, “Beteja e Buqes” dhe “Qereza” në fshatin Buqe – 70,000 euro;
29. Ndërtimi i stadiumit në fshatin Plaavë – 70,000 euro;
30. Kubëzimi i rrugëve në fshatin Plavë – 20,000 euro;
31. Ndriçimi publik në qendër të fshatit Plavë – 20,000 euro;
32. Ndërtimi i Prronit në Rrugën “Kreveqica” në fshatin Plavë – 8,500 euro;
33. Kubëzimi i rrugëve, ndërtimi i mureve mbrojtëse në Rrugën “Abdyrrahman Gërdellaj” në fshatin Rrenc – 70,000 euro;
34. Ndërtim i rrugës Xërxe-Rrenc në fshatin Xërxe – 30,000 euro;
35. Ndërtimi i fushës sportive në fshatin Pllajnik – 45,000 euro;
36. Kubëzimi i rrugëve dhe infrastrukturës përcjellëse në fshatin Shajne – 120,000 euro;
37. Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në fshatin Kukajan – 50,000 euro;
38. Kubëzimi i rrugës në Rrugën “Peto Mahalle – Shokovce”, likeni dhe rregullimi i Prronit nga “Gjonjet” në fshatin Brod – 180,000 euro;
39. Ndërtimi i parkut në fshatin Dikancë – 40,000 euro;
40. Kubëzimi i rrugëve në Rrugën “Baçkë”, varrezat në fshatin Baçkë – 50,000 euro;
41. Ndërtimi i terreneve sportive në fshatin Leshtan – 50,000 euro;
42. Kubëzimi i rrugëve në qendër të fshatit Radeshë – 90,000 euro;
43. Ndërtimi i murit mbrojtës, parkingu në fshatin Kërstec – 80,000 euro;
44. Hapja e pusit në vendin “Brod” dhe rregullimi i ujësjellësit në vendi “Barbulla” në fshatin Gllloboqicë – 123,000 euro;
45. Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Krushevë – 130,000 euro;
46. Kubëzimi i rrugëve, ndërtimi i trotuareve, si dhe rregullimi i Prroit në fshatin Vraniçë – 70,000 euro;
47. Ndërtimi i Prronit, renovimi i fushës së sportit në fshatin Rapçë – 130,000 euro;
48. Ndërtimi i murit dhe kubëzimi i rrugëve në fshatin Orqushë – 30,000 euro;
49. Kubëzimi i rrugës dhe ndërtimi i kanalizimieve në fshatin Zlipotok – 90,000 euro;
50. Kubëzimi i rrugëve në Rrugën “Llukov” në fshatin Restelicë – 260,000 euro;
51. Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Libevishtë – 70,000 euro;
52. Kubëzimi i rrugëve dhe ndërtimi i murit mbrojtës në fshatin Mlikë – 40,000 euro;
53. Ndërtimi i Shtëpisë për Personat me Aftësi të Kufizuarra – është paraparë gjatë këtij viti;
54. Ndërtimi i stadiumit në fshatin Blaç – 100,000 euro;

55. Ndërtimi i stadiumit dhe infrastrukturës përcjellëse në Dragash – 185,000 euro;
56. Ndërtimi i pllakës dhe kulmit, si dhe renovimi i SHFMU “28 Nëntori” në fshatin Bresanë – 21,745 euro;
57. Renovimi i Shkollës Filllore në fshatin Restelicë – 60,000 euro;
58. Ndërtimi i këndit të lojërave për fëmijë në Shkollën Fillorë “28 Nëntori” – 30,000 euro;
59. Ndërtimi i rrugës dhe oborrit të Shkollës Filllore “Ulina” në Kosavë – 3,000 euro;
60. Ndërtimi i nyjeve sanitare dhe hapësirës multifunktionale në Shkollën e Mesme “Ruzhdi Berisha” në Dragash – 40,000 euro.

Pra, në total kemi 4,714,448 euro investime kapitale të planifikuara. Realisht, veç kanë pësuar ndryshime me donacionin të cilin e kemi fituar tash, që mund të ju njoftoj kryetari.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë e hapim diskutimin. Ju kisha lut – diskutimi do të jetë 10 minuta, atij që do t’i përmendet emri të marrë replikë, atij që nuk i përmendet nuk do t’i jap replikë.

Nexhat Selaj: Faleminderit! E përcolla – pavarësisht se materialin e patëm, po më duket se ishte e tepërt me dalë drejtori këtu edhe me dhënë sqarime, se ne materialin e kemi dhe rreth këtij materiali duhet të orientohemi dhe të flasim. Pavarësisht nga ato, unë do të ndalem tek investimet kapitale. Thaje se rreth 4,700,000 euro të investuara ... nuk do të kisha thënë që e qëllimtë, u bë, që dy herë, edhe seancën që shkoi kryetari rrijke mbrapa me drejtorin, as që dëgjojke çka flitsha, as tash. S’po them me qëllim, po e dyta herë po përsëritet. E përcolla me vëmendje drejtor, 4,700,000 euro investime kapitale. Këtu do të isha ndalë te drejtori i DKA-së, z.Krasniqi. A hiç nuk ke qenë aty pjesëmarrës, në shpërndarjen e 4,700,000 eurove, 40 mijë euro të ndahen për Shkollën e Mesme të Lartë “Ruzhdi Berisha”? Vetë ke qenë profesor edhe ne të gjithë jemi pjellë e asaj shkolle atje, edhe të gjithë jemi falë atyre arsimtarëve, profesorëve të ndjerë të cilët na kanë nxjerrë sot që të flasim këtu. 40 mijë euro, kjo është... besoj se vetëm më shumë se hajgare, s’di çka është. Ta dini ju kolegë asambleistë, edhe ju pushtetarë, por edhe dëgjuesit le të dinë, se Shkolla e Mesme “Ruzhdi Berisha” është akademi për këtë region, akademi i shkencës. Që t’i ndahen akademisë së shkencës – se këtu thuhet arsimit dhe shkencës – arsimit dhe shkencës në Shkollën e Mesme “Ruzhdi Berisha” 40 mijë euro, është hajgare. Drekat dhe darkat na kushtojnë më tepër, e investimet në këtë shkollë 40 mijë euro, unë nuk e di çfarë drejtori kemi edhe çfarë presim në të ardhmen. Pse drejtor nuk merresh me aneksin e Shkollës “Ruzhdi Berisha” që dy vite të ka mbet? Ka qenë projekti 2023-2024, projekt dyvjeçar, shumë mirë e di, nuk ka desht ta qes si problem 2023, se e di shpesh se do të thoni në 2024 do të përfundojë. Tash po vjen korrike, drejtor. Kur kanë me përfundue ato punimet, kur vetëm është betonuar pllaka edhe janë qitur katër stuba, shtylla

të betonit. Nëse s'është ashtu, mundesh me shkue me e vizitue se një herë ke qenë krejt-krejt që është ndërtuar, prej se ke ardhë si drejtor. 2024-ta mbaroi, kur do t'i biesh punëtorët me punue? Gjithsaherë investimet në atë shkollë, në atë akademi që unë e mbroj me mish e me shpirt, na i bien punimet. Jo vetëm tash, unë e kam kritikue edhe partinë time në të kaluarën. Në shtator vijmë. Ne a do të merremi me mësim, a do të merremi me punime, a do të merremi me zhurmën e cila krijohet nëpër shkollë, edhe çka i mbet kësaj shkolle? Nëse ne i quajmë akademi, ejani e kqyrni në atë akademi çka ka. Me 40 mijë euro, drejtor, asnjë kabinet nuk e ke, a s'e ke turpin të vish e të ulesh këtu edhe të më dëgjosh mu, edhe të dëgjojnë ty 500 nxënësia edhe 60 profesorë, asnjë kabinet funksional nuk e ke. Çfarë do të bësh me 40 mijë euro? Lirisht bleje një makinë, mos u bredh rrugëve poshtë e lartë, me dy letra në dorë, blejë një makinë luksoze bare ta bëjmë për hajr. 40 mijë euro, është turp që të flasim për Shkollën e Mesme "Ruzhdi Berisha". Turpet vijmë e shtohen! Tash e patëm Testin e Arritshmërisë, a për 100 euro dreka t'u dhimtën me ua pague kontrollorëve të cilët ishin të shkëlqyeshëm, dhe erdhën e bënë një performancë të jashtëzakonshme. Jo drekë, nuk pate guxim nga një kafe t'ua sjellësh administruesve. E ti shumë mirë e dish, ke qenë pjesëmarrës nëpër shkolla tjera, ta marrin fytyrën njerëzit. Me dreka, me darka, me ushqime t'i paguajnë, vetëm që shkojsh si mund atje. Këtu nuk ke qenë në gjendje – 20 vetë i ke pas, ka 5 euro një drekë – për 100 euro. Bare tregojsh! Nëpër emaile, dërgojsh emaile se nxënësit duhet të marrin nga një laps dhe nga një ujë të pijes. Është turp nga një laps 5 cent me ia kërkue nxënësit me ardhë ditën e maturës. Një ujë me e pru! Ti i ke pru ato, po ia ke bë sikur kur e bien dhalltin masi të hahet pitja. Nxënësi pesë orë vjen, me atë ujin e nxehtë rri në orë, e ka boll stresin e vet, ti kërkujsh me e pru një laps edhe një gotë ujë. Unë nuk po dua të jam shumë i ashpër para, se ndoshta të duket shumë i ashpër, veç nëse nuk janë këto të vërteta, kam qef nga goja jote, jo nga kryetari, eja dhe ballafaqohu me mu këtu, edhe me ata kolegët që janë duke të përcjellë të gjithë, edhe me ata nxënës që janë duke të përcjellë të gjithë. Ne kur vjen në pyetje shkumësa me ble, duhet me e bo një kërkesë. Ktheja autonominë e parasë, vetëqeverisjen e parasë shkollave. Jo ka dalë tenderi, jo s'ka dalë. Ne e kuptojmë çka është puna e tenderit, vetëm kuptoje se ai është material harxhues i përcëditshëm, shkumësi është i përcëditshëm, letra është e përcëditshme. Nuk po them investimet, karrikat e tjera, vetëm këto të përcëditshmet, ktheni fondacionin që të menaxhojë drejtori, që të menaxhojë stafi menaxherial nëpër shkolla. Faleminderit! Kisha pas qef me dalë vetë këtu, me u ballafaque me mu, jo me ma qit kryetarin ose dikë tjetër, me t'i mbulue këto të cilat i ke bërë deri tash. Faleminderit!

Afrore Vejseli: Faleminderit, kryesuese! Përshëndetje për të gjithë ju të pranishëm! Para se të marrë fjalën rreth pikës së KAB-it, këto ditë Komuna jonë u ballafaqua me vërshime të mëdha, dëme të mëdha, por falënderojmë Zotin që njerëzit janë mirë dhe urojmë që të mos kemi më ditë si këto. Pra, presim përkrahjen e Komunës, si nga ana morale, ashtu edhe financiare, për këto familje të prekura. Diskutimin tim në lidhje me këtë pikë do ta përqendroja në planifikimin për vitin 2025-2027. Nëse e

shikojmë listën e shpenzimeve, një gjë bie në sy, se projektet e paraqitura janë aq të përgjithësuara, sa që çuditësh se ku do të punojmë me këto projekte. Nëse e shikojmë për nga numri i shpërndarjeve të projekteve, dhe këtu nuk është mirë. Ka fshatra që paraqiten në një projekt, e punët e këtyre projekteve janë ose mure mbrojtëse, ose kubëzime në pjesën më të madhe Projektet paraqiten nga përfaqësues të fshatrave, por projektet e tilla duhet të marrin edhe një miratim, e jo të bëhn paushall. Po ju jap një shembull: Projekti në Zgatar Ndërtimi i murit mbrojtës te Kuji i Mullirit dhe kubëzimi po në këtë vend. Muri mund të rregullohet nëse është në vendin me emër Kuji i Mullirit, por kubëzimi nuk mund të bëhet, pasi që rruga është e shtruar me asfalt. Këso lloj projekte ka edhe në vendet tjera. Këto ditë do të bëhet edhe pranimi i fushës sportive, e kam fjalën për Stadiumin e qytetit të Dragashit që është bërë një punë e mirë. Ajo që më shqetëson mua është pjesa e infrastrukturës, që është për të ardhur keq. Më mirë me thënë që po përurohet pjesa e investimeve të federatës, e për pjesën tjetër se çka do të bëhet nuk e di. Tjetër gjë që bie në sy është se të gjitha shkollat kanë këndin e lojërave për fëmijë, vetëm në shkollën e Zgatarit, ky kënd është duke u parë në ëndërr. Edhe pse, fëmijët e kësaj shkolle e meritojnë këtë, por ndoshta për ju këta nuk janë të denjë. Po vazhdon i njëjti avaz, sikurse te transporti, ku 2.5 km rrugë, këta fëmijë me kombi udhëtojnë vetëm 1 km, kurse pjesën tjetër udhëtojnë në këmbë. Ju faleminderit!

Edin Kurt: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Këtu para meje kam propozim-buxhetin për investime kapitale në Gorë në vitin 2025, siç i është dërguar z.Qamil Kolonit nga zyra për komunitete. Ka një problem sa i përket fshatit Gllagoçicë, materiali që kemi marrë sipas tij thotë hapja e një pusi në pjesën e Bredorit, rregullimi i ujësjellësit në vendin e Barbulës në fshatin Globoçicë 123.000. Kërkoj që këto mjete të shpërndahen siç janë dërguar në propozim buxhetin, pra vazhdimi i projektit dhe shtrimi i rrugëve, muri mbajtës dhe ndërtimi në total, pra 123 000 000 sa është dërguar këtu, vetëm se këto fondet të shpërndahen ashtu siç janë dhe të dërgohen në propozim-buxhetin, në mënyrë që më vonë të mos ketë probleme me realizimin e këtyre projekteve.

Nedžmidin Sejdir: Faleminderit zonja kryetare, së pari jam i indinjuar që ju si qeveri keni treguar hipokrizi politike ne kemi pasur fatkeqësi natyrore në komunën tonë. Të paktën tregoni vizualisht se ju intereson vërtet të gjithë ata qytetarë. Tjetër gjë, zonja kryetare, dua t'ju lus që kur jeni tashmë në kryesimin e Kuvendit, të lexoni rregulloren e Kuvendit, në të cilën saktësisht thuhet se çdo delegat ka të drejtën e 10 minutave prezantim + dy minuta kohë shtesë, konsultohuni me këshilltarët tuaj të vërtetë ligjorë. Gjëja e tretë, zonja kryetare, sapo dëgjova nga gjyshi se në projektbuxhetin merr pjesë shefi i zyrës së komunitetit, mendoj se informacionet nga debatet publike duhet t'i kishit marrë direkt nga qytetarët e komunës sonë, mendoj qytetarët e komunës sonë. Komuna jonë e di më së miri se çfarë kanë nevojë, zonja kryetare tani do të flas me drejtorin e ekonomisë viti 2025. Më pas, zotërinj, keni parashikuar 20 mijë euro të tjera për vitin 2026 dhe 20 mijë euro të tjera për vitin 2027. Kështu është

shkruar, ndaj më interesojnë konkretisht detajet se cilat rrugë do të ndërtoni përmes Kukuljanit për këto 90 mijë euro në tre vitet e ardhshme. Po ashtu zoti Koloni në fshatin Brod Mëhalla Šokovci Lika, rregullimi i përrrenjve dhe rrugëve, keni parashikuar 180.000 euro për vitin 2025, pastaj për 20.000 për vitin 2026, keni parashikuar 40.000 euro të tjera për vitin 2027. Do të doja t'ju kërkoja të vini këtu dhe të na tregoni detajet e këtij projekti. Ndoshta e kam gabim dhe mendoj në mënyrë të palogjikshme, por më duket se janë shumë para për disa projekte të tilla, do t'ju lutesha të më shpjegoni në detaje se ku do të shpenzohen ato para, atëherë zoti Koloni keni euro. 70,000, gjithsej 40,000 euro në 2025 në fshat, pastaj keni parkingje të tjera 40,000 euro në 2026 sipas tabelave tuaja, keni 70,000 euro të tjera në 2027 të destinuar për ndërtimin e një parkingu në fshatin Dikance. Ku do të jetë ai parking dhe si do të duket nëse mund të vini edhe ju këtu për të shpjeguar hollësisht sepse vendasit e atij fshati të Bačkës po pyesin, ju zoti Kolona keni parashikuar për bixhoz rrugën deri te varreza. 50,000 euro në 2025, atëherë keni parashikuar 50,000 euro të tjera në 26 vjet dhe më shumë 50,000 euro në 2027, që është gjithsej 150,000 euro, më intereson madhësia e rrugës, ato rrugë dhe si do të shpenzohen gjithë këto para. ndertimi i nje fushe sportive ne fshatin Leshtane ne vitin 50 000 euro, ne 2026 50 000 euro dhe ne 2027 50 000 euro te tjera, qe e ben totalin 150 000 euro, me intereson se ku do te jete fusha sportive. Si do të duket fusha sportive prej 150 mijë eurosh që do ta ndërtoni në fshatin Leshtanë, atëherë keni në Krushevë, zotëri, ndërtimin e ujësjellësit në vitin 2025, për 26 vjet, 70 mijë euro, dhe në vitin 2014. Në vitin 2027 janë planifikuar edhe 70.000 euro që janë gjithsej 270.000 euro, mendoj se qytetarët e komunës sonë meritojnë një përgjigje të detajuar për këtë çështje. Në fshatin Restelicë Lukov dhe Jezercë të fshatit Restelicë 260 mijë euro në vitin 2026 dhe 2027. Nuk keni paraparë investime në fshatin më të madh të Gorës, nuk i keni në tavolina, kolonat janë bosh. Më tej zoti Koloni për të mos e zgjatur shumë, këtu e keni paramenduar një stadium në Bljac, është i njëjti stadium ku të gjithë kolegët tanë këshilltarë ngritën dorën dhe njëzëri votuan që stadiumi të ndërtohet urgjentisht, urgjentisht të ndërtohet ai stadium, 100.000 euro. në vitin 2025, atëherë keni parashikuar 200 mijë euro të tjera në vitin 2026 dhe keni parashikuar 200 mijë euro të tjera në 2027, që në këtë draft janë 500 mijë euro. Sa para kemi shpenzuar deri tani, unë personalisht kam qenë në atë stadium Uran, ju e dini shumë mirë, ishim bashkë dhe pashë që gardhi që keni ndërtuar është totalisht i rrezikshëm për popullatën e moshuar, dhe jo, Zoti na ruajt nëse Fëmijët afrohen pranë gardhit, sepse një erë pak më e madhe mund ta rrëzojë atë dhe përveç kësaj, zoti Kolloni dhe ju, zoti kryetar, zonja Presidente, do të ishte mirë sikur të na kujtonit të kujtonim pak pushtetin ekzekutiv për mirësjellje. Takimi. Zoti kryetar tash po ju pyes direkt, ju erdhët në këtë foltore dhe na bindeni, më bindeni edhe mua që klubit të futbollit i duhet një fushë për stërvitje dhe thatë se keni një donator këtu që do t'i japë bashkisë rreth 200 000 euro per ndertimin e stadiumit po ai stadium duhet te perfundohet urgjent se duhet tani me intereson nese e keni filluar me ndertimin e stadiumit ne fillim te mandatit kur keni marre 2022 ne janar ne fillim me mohoni nga

foltorja z.kryetar bashkie nuk ka problem por do marrim edhe procesverbalin dhe pastaj do bejme gjithcka te diskutojme qe nese keni filluar ndertimin e ketij stadiumi ne fillim te mandatit sa eshte urgjenca o njerez shtat vjet , nuk arrij ta kuptoj as kam probleme me logjiken ose ju e llogaritni kohen ndryshe, e treta zoti kryetar, ju keni parapare 185.000 euro per stadiumin ne Dragash dhe keni njoftuar ne facebook se do ta hapni ate stadium. Si mund te hapesh nje stadium qe nuk ka perfunduar akoma dhe une kam problem me logjiken ketu, dmth nese e ke hapur kohet e fundit ate stadium duhet ta hapje dhe por per shkak te problemeve te motit me te cilat u perball komuna jone. , nuk munde dhe nuk të fajësoj për këtë, investon edhe 185 mijë euro në atë stadium, pastaj në 2026 200 mijë euro në atë stadium dhe në 2027 200 mijë euro që janë 2 milionë. Mendoj se këto stadiume olimpike nëpër botë kushtojnë shumë më pak se kaq, zonja dhe zotërinj, të nderuar kolegë këshilltarë, kërkoh ndjesë që kam marrë pak më shumë kohë dhe pres që ekzekutivi të më japë përgjigje të detajuara për pyetjet që kam ngritur në këtë kuvend. dhe nga zonja Presidente pres që të konsultoheni me stafin tuaj ligjor, rregullorja e Kuvendit ka të drejtë për 10 minuta prezantim dhe + dy minuta prezantim shtesë nëse është e nevojshme, përveç replikës, nëse është e nevojshme, faleminderit..

Driton Ademi: Atëherë, me sa e kam parë listën e shpenzimeve kapitale, prej 52 pika që janë bo këtu, mbi 70% e këtyre pikave janë kubëzim, kanalizimi, ndriçim. Është një avaz që neve na kanë akuzue nga qeverisja e kalura, janë duke e bo edhe avazin e njëjtë. Unë do të dal te pika e shëndetësisë, drejtor, të cilën ti e ke përfshirë te shërbimet sociale këtu, edhe e ke përfshirë që thajë me donatorë. Grantin edhe të hyrat i ke planifikue për vitin 2025, afër 1,480,000. A nuk ka asnjë investim kapital në shëndetësi për vitin 2025, përveç pagave të cilat janë të përfshira këtu? Nuk ka asnjë investim në shëndetësi për 2025-tën. Në listën e investimeve kapitale nuk po e shoh dikund, veç nëse e keni ju personale të juajën. Do të dal te disa fshatra këtu, të cilat për mu është shumë çudi, do investime të palogjikshme, shumica që duhet me u investue në projekte tjera. Po filloj me fshatin Blaç, që e kam parë pak të paarsyeshme park me vonue në mahallën “Prifte”. 50 mijë euro dëm veç kot është me i çue. Park po shkruan, ndërtimi i parkut në Rrugën “Shëndija”, mahalla, edhe mahalla “Prifte” po shkruan qetu. “Prifte” në fshatin Blaç. Edhe qekjo që është më e keqja, te qekjo lista e shpenzimeve për 2025, nuk e kam parë unë – vitet e kaluara kanë kërkue edhe emërtimin e rrugëve ku kanë me u investue këto. Te këto pika shumë pak ka emra të rrugëve, që s’besoj që Ministria edhe munden me e pranue këtë pa emra të rrugëve. Po dal te fshati Bresanë, kubëzimi i rrugëve në Rrugën “Luftëtarët e Lirisë”, Rruga e Zgatarit – kjo Rruga e Zgatarit kryetar, rruga kah ti është rruga më e mirë që u investue qe 24 vjet bon vaki, s’di ku ke me investue këtu. Rruga “Imamaj”, ndërtimi i murit mbrojtës Danaj, ndërtimi i parkut në qendër. Qaj parku për sa ka me zgjat, kryetar, a bën me e ditë, në Bresanë? 2023-2024-2025, edhe e ke planifikue edhe në 2027-tën 200 mijë euro. Është për çudi! Kubëzimi i rrugëve në fshatin Kuklibeg – 50 mijë euro. Nuk e di ku kanë me e shtrua gjithë atë kubëzim, kam pas një ankesë që 50 mijë euro

kubëzim nuk ka mund me pas, ku ka mund me u shtrua ky kubëzim. Një dukuri tjetër që e kam pa, ndriçimi publik në qendër të fshatit Kuklibeg. A vetëm qendra, drejtor, ka me u bo ndriçimi publik, 30 mijë euro? Veç te Saraji nashta, se qatë e kanë qendrën, 30 mijë euro në qendër e keni. Nashta është gabim teknik ose...nuk po besoj që e keni bo pa qëllim, se e keni bo edhe në fshatin Brrut në mos gabofsha. Meni s'ë di a e ka vërjet a jo në fshatin e vet. Edhe në fshatin Pllavë i keni shkruar nja 20 mijë euro vetëm në qendër të fshatit Pllavë, ndriçimin publik. Llogarite – kubëzimi i rrugëve në qendrën e fshatit Buzez – 50 mijë euro, qendra, xhamia qajo, me sa e di unë, sa kam ec në Buzez. 50 mijë euro jo Buzezin, po edhe dy-tri katunde tjera 50 mijë euro me kocka i shtrosh. Veç si t'ia u shtini edhe në derë të shpisë mo dikuj brenda, qysh i thona na, në derë të hotnikit dikuj nëse doni me ia shti. Ose nashta, jo këso kubëza çfarë po i shtroni rrugëve, nashta pllaka të banjove veç si t'i shtroni. Nuk e di unë, nashta fshatarët e fshatit Buzez kanë ma shumë nevojë për të tjera sende, sesa për kubëza. Ndriçim publik, siç e thashë Men, e keni në qendër të Brrutit 20 mijë euro. Veç në qendër 20 mijë euro. Llogarite, 40 mijë euro ka kushtue gjithë Bresana, 20 mijë euro Brruti veç qendra po ju kushton. Nuk është e cekur, Brruti është një, nuk e kanë nda. Edhe një pyetje e kam në fund për kryetarin. Kryetar, vjet e ke bo dëgjimin buxhetor – më vjen mirë që e ke bo, se u bo mas disa vjete – po e kam një ankesë për këtë dëgjimin buxhetor. Dëgjimin buxhetor e ke bo sa për sy e faqe, që i ke mbledhë prej Zaplluxhes e deri në Pllajnik, edhe atë a e dish për çka i ke mbledhë, i ke mbledhë veç për Grantin e Performancës, me e shtue një plus për vete, për me e përfitue Grantin e Performancës. Po më vjen shumë keq me të thënë, veç për Grant të Peformancës, edhe atë i ke mbledhë prej fshatit Pllajnik deri në fshatin Zaplluxhe. I vetmi kam qenë opozitar – e dish shumë mirë – ka qenë ëmë duket edhe Samidini, nuk e di sigurt – i vetmi kam qenë opozitar që kam qenë në atë dëgjim publik. Edhe apat kam me marrë pjesë, po pyetjen e kam. Kam marrë pjesë, kryetari ka qenë prezent, kam marrë pjesë, edhe drejtori ka qenë prezent. Pyetjen e kam konkrete. Kryetar, a do të mbash dëgjime publike me secilin fshat veç e veç, jo me i mbledhë sikur qysh i ke mbledhë herën e parë? Faleminderit!

Shpetim Hajredini: Sot po diskutojmë për një dokument i cili është shumë i rëndësishëm, sa i përket Kuvendit Komunal dhe ekzekutivit natyrisht. Qysh nga sot fillon planifikimi se çka do të kryhet në vitin 2025 dhe çka do të investohet për qytetarët e Dragashit. Prandaj, tre muaj ditë kemi hapësirë dhe të gjithë qytetarët kanë hapësirën e duhur, që nëse mendojnë të shtojnë diçka apo të ndryshojnë e kanë opsionin e hapur edhe mund të drejtojnë ato prioritetet e tyre tek ekzekutivi. Tani u mbetet ekzekutivit t'i marrin parasysh. I nderuar drejtor i Financave, do të kyçem pak te prioritetet e Komunës, dua të diskutoj pak për këto prioritete dhe pastaj të kaloj te investimet kapitale për të cilat u diskutua deri më tani. Një prej prioritetëve të Komunës është edhe forcimi i ekonomisë komunale, me mundësi të barabarta për të gjithë. Rritja e ekonomisë komunale përmes përmirësimit të standardeve të arsimit dhe nivelit të arrijtes, pajisjet shkollore, renovimet shkollore, përmirësimin e kushteve në arsimin fillor dhe

atë të mesëm; mbështetjes direkte të sektorit bujqësor dhe blegtorisë përmes subvencionimit të grave dhe burrave fermerë. E para, i nderuar drejtor - përmirësimi të standardeve të arsimit dhe nivelit të arrijtes – besoj shumë fuqishëm se ndikon në fuqinë punëtore profesionale, por nuk e di sa ndikon në rritjen ekonomike, se nëse e kemi një fuqi punëtore profesionale, absolutisht unë e di që ndikon në të mirën e ndërmarrjeve. Por, në rritjen ekonomike s’e di sa po ndikon. Por tjetra, nëse nuk ka ndërmarrje edhe kjo fuqi punëtore do të largohet siç është duke u larguar deri më tani. Do të kisha pas dëshirë ta marrë një përgjigje tuaj, pse e keni marrë si kyçe përmirësimin e standardeve të arsimit në rritjen ekonomike? Tjetra, mbështetje direkte të sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë, absolutisht ndikon edhe gjithmonë e kam kërkue që ky sektor të jetë prioritet për këtë ekzekutiv, se i vetmi është i cili do të mund të ndikojë në zhvillimin ekonomik, në hapjen e vendeve të reja të punës, të cilat do të ndikojnë në moslargimin e familjeve nga Komuna jonë. Por, kjo gjithmonë ka hasur në vesh të shurdhër, edhe në këtë ndarje të projekteve e pashë se prapë këta dy sektorë janë lënë anash. Kemi një rritje të subvencioneve, por të cilat nuk e dimë se ku do të shkojnë edhe ato. Do të përqendrohen të gjithë anë blegtori dhe bujqësi? S’ka mundësi, se i kemi edhe arsimin, i kemi edhe tjerat të cilat sot i pashë këto, asistencë sociale të cilat do të ndihmohen përmes subvencioneve. Pra, prapë kjo do të përgjysmohet dhe bujqësia dhe blegtorja do të mbeten me të njëjtin subvencionim si vitet e kaluara, nuk ka ndryshim fare. Absolutisht kjo nuk është e drejtë dhe të gjitha këto premtime apo si t’i quajmë, të cilat i keni shënuar në këtë material, kanë me mbetur vetëm si shënime dhe nuk do të ndikojnë asgjë në të mirën e qytetarëve, ashtu po mendoj unë. Nëse ti mendon ndryshe dhe ke argumente, dalish dhe ma argumentosh ndryshe. Patjetër që do të dal edhe tek lista e shpenzimeve kapitale. Unë nuk po e di tash, drejtor, prita që do të bësh ndryshime pas ndodhisë dhe vërshimeve të cilat kanë ndodhur. Se ju s’e di sa e dini, unë i mora do informacione që qeveritë e mëhershme, po edhe kjo qeveri nuk ka ndihmue deri më tani ndonjë komunë. Nëse keni informacion që ka ndihmue deri më tani ndonjë komunë që ka pas fatkeqësi natyrore, ma tregoni. Deri më tani qeveritë nuk kishin ndihmue asnjë komunë nga fatkeqësitë natyrore. Andaj, kish qenë mirë që, ky planifikim i cili është bërë para vërshimeve – ju dje e keni diskutue, mos të dalë në atë temë, pasi që do të diskutoj në pikën e rendit të ditës për të cilën edhe e votuam – është dashtë ta keni parasysh që t’i ndryshoni këto. Ju nuk i keni ndryshue, i latë të njëjtat dhe natyrisht që do të votohen këto në fund kështu si janë. E para që deshta ta diskutoj, e diskutoi edhe më herët kolega Driton, për të cilën edhe më kanë urdhërue që ta paraqes para jush, fshati Kuklibeg. Ndryçimi publik në qendër të fshatit, kish qenë mirë ta ndryshoni si emër, si emërtim, mos ta bëni “qendër”, por të jetë në tërësi të fshatit. 30 mijë euro janë të mjaftueshme për instalimin e rrjetit e ndryçimit publik në tërë fshatin, se është i vogël, unë e di sa më ka kushtue në fshatin Kuk, për atë edhe po e them me bindje të plotë se është i mjaftueshëm 30 mijëshi për instalimin e rrjetit të ndryçimit në tërë fshatin. Të mos mbetet ky emërtin siç është këtu. Pastaj pwr tw tjerat, pwr fshatin Kuk do tw flas

nw fund, pwr projekte tw cilat i kam kwrkuar edhe vitet e kaluara dhe tani nuk po i shoh fare kwtu, nw kwtw planifikim buxhetor. Kam thwnw vitin e kaluar dhe kam diskutuar edhe me drejtorin e Bujqwsisw, i cili sot nuk wshtw kwtu, shumicwn e seancave atw as qw e shoh, po pak ka rwndwsi. Nwse jeni ju kwtu edhe kryetarin e kemi fatmirwsisht kwtu. Kam kwrkue qw nw projektet kapitale tw vitit 2025 tw jetw edhe furnizimi me mekanizwm bujqwsor, dhe kwtu nuk e pashw askund që është bërë një planifikim i tillë. Dhe tjetra, të cilën shumë herë ia kam bërë pyetjen kryetarit dhe më ka premtue që do ta ketë parasysh. Tha që e kemi edhe një vit dhe prapë nuk e pashë, apo ndoshta e keni planifikue diku tjetër, në ndonjë kod që unë nuk e kam lexue edhe nuk e kam kuptue ndoshta. Pagesën e shpenzimit të ndriçimit publik të atyre fshatrave të cilët deri më tani e kanë krye me financa të veta. A e keni planifikue diku tjetër, delni ma jepni një përgjigje, nëse e keni planifikue është në rregull. Nëse jo, do ta bëj si propozim para votimit të KAB-it që të jetë në investimet kapitale edhe pagesa e shpenzimeve. Tjetra shëndetësia, e pashë që nuk keni planifikue asgjë, por po shpresoj që të jetë gjithçka në rregull. Nëse është në rregull, atëherë absolutisht as unë nuk jam që të investohet ku është në rregull dhe është mirë. Por, unë e kam thënë edhe në diskutimin e janarit, që kam pas shumë ankesa dhe - shumica prej jush besoj se keni qenë këtu – kam thënë që nuk kam dëshirë që të merrem me shëndetësi se nuk jam i atij profilit. Po pas disa pyetje të shumta të qytetarëve që më janë bërë, jam detyrue edhe në atë kohë që ta parashtroj pyetjen, nuk më ka dhënë përgjigje drejtori i Shëndetësisë, kryetari s'ka qenë fatkeqësisht në seancë. Pse laboratorit nuk ka funksionue një kohë të gjatë, çka ka ndodhë, dhe rëntgeni gjithashtu nuk ka funksionue dhe a funksionon tani? Nëse janë funksionale këto, atëherë jemi në rregull. Dhe tjetra, AMF-të pa mjekë, mos të themi edhe pa infermierë. Çka mund të bëni, kryetar, që së paku të kenë dy apo tri ditë të kenë mjekë këto qendra. Keni mundësi të sjellni mjekë në këto qendra të mjekësisë familjare apo jo? Besoj që profa e ka kompletuar gjithçka çka duhet të thuhet për arsimin. E kam planifikuar qysh nga ardhja e materialit që do ta paraqes këtë shqetësim timin të cilin e kam paraqitur edhe në vitin e kaluar. Tani në momentet e fundit deshta ta tërheq, por jo, prapë do ta paraqes. Pastrimi i shtratit të lumit, e kam kërkuar edhe vitin e kaluar. Fatkeqësisht, ndodhi ajo çka ndodhi, aty nuk diskutoj se është fuqia e Zotit dhe ne s'mund t'i dalim para fuqisë së tij. Por, kryetar, është mirë që së paku edhe këtë vit të planifikojmë diçka dhe të bëjmë pastrimin e shtratit të lumit. E kam thënë për të gjitha fshatrat që kanë lum, se të gjitha janë të ngarkuara me mbeturina të ngurta, familjare, pra janë të bllokuara. Prandaj është mirë që të planifikojmë diçka që së paku t'i pastrojmë. Për zgjerim nuk po flas, se nuk e di nëse kemi mundësi apo jo, por t'i pastrojmë. Ajo çka erdhi para dy ditëve ishalla do Zoti edhe nuk na ndodhë kurrë, por ne kemi mundësinë t'i planifikojmë, buxhetin e keni të duhurin, keni buxhet të mjaftueshëm, vetëm ju duhet vullneti. Nëse keni vullnet, do ta bëjmë edhe këtë. Nëse më ka kalue minutazhi, atëherë për pyetjet tjera vazhdoj në eventuale. Faleminderit!

Jetmir Ajdini: Përshëndetje për të gjithë! Me gjithë këtë planifikim për investime kapitale në Komunën tonë për vitin 2025-2027, do ta kisha pyet Qeverisjen Komunale, pse nuk është përfshirë në këtë planifikim edhe drejtori i Shëndetësisë. Pse s'është ndarë asnjë cent për shëndetësi dhe nuk është planifikue asnjë cent për shëndetësi për këto planifikime trevjeçare. Apo gjendja në shëndetësi, në QKMF-në tonë dhe AMF-të tona e kemi gjithçka të rregulluar dhe nuk e kemi asnjë problem dhe nuk duhet të investojmë asnjë cent. Për qytetarët tanë të cilët kërkojnë shërbime çdo ditë në këto QMF të Komunës sonë. Pyetja kryesore është kjo, në lidhje me këtë ndarje buxhetore që është planifikuar. Tjetra pyetje që do të bëja, nuk e shoh në planifikim buxhetor investimin në pompat e ujit në fshatin Zgatar, projekt i dështuar vitin e kaluar. Për shkak të vonesës së juaj, mjete buxhetore kanë qenë të ndara, për shkak të vonesës suaj në tenderim, ka dështue ai projekt, mjetet janë kthye në suficit. Nuk e shoh të planifikuar diku këtë investim në pompat e ujit. Kërkesë e disahershme e imja, në këtë Asamble Komunale. Premtim që do të bëhet, nuk është bërë deri më sot asnjë përmirësim. Është nevojë urgjente, ka nevojë urgjent të intervenohet në ato pompa të ujit, për arsye se fshati Zgatar furnizohet përmes atyre pompave me ujë. Një pyetje tjetër që do të doja ta bëja, është edhe rruga e cila është në familjen Murati, rrugë e cila ka mbet përgjysë, gjysa është investue dhe gjysa e asaj rruge është e papërfunduar. Më keni premtuar që do të gjeni mjete dhe do ta përfundoni edhe atë rrugë. Është ende e papërfunduar dhe ka mbet përgjys. Këto janë disa nga pyetjet të cilat do të doja përgjigje. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, znj.kryesuese! E kemi listën e shpenzimeve kapitale, njëfarë planifikimi goxha i mirë me shifra marramendëse. Po shumë interesant që ndër të tjera, përveç projekteve të cilat unë s'muj me folë, se nuk i kam vizitue edhe nuk e di çka ka ndodhë atje. E kemi kubëzimin e rrugëve në fshatin Blaç, Rruga "Livadhi Begit" edhe "n'Kodër", njëfarë planifikimi. Ato para i kemi pas ne të parapara edhe në buxhetin për vitin 2024-2025. Veç që vlera është rrit. Granti është 50 mijë euro, 2026-2027 janë ndarë ka 50 mijë euro, domethënë 100 mijë euro, kjo rrugë ka me shkue bon vaki deri në Libehevë me gjithë ato pare, se një pjesë e madhe e rrugës është veç e kubëzuar në Kodër atje nalt. Ajo çka po më bën shumë përshtypje dhe vazhdimisht e kam cek, është rregullimi i ujëmbledhësve dhe renovimi i kaptazhave. Janë kaptazhat e famshme që unë vazhdimisht kam folë, vazhdimisht e kam shfaq si keqpërdorim, hala paski me i bo këto kaptazhe, janë bo këto në dokumentacion, tash kishe prapë të planifikume. Uji ka qenë i papijshëm gjatë vërshimeve, s'e di a e dini, në fshatin Blaç ka qenë i papërdorshëm, bile-bile edhe për pastrim s'kemi mund me e përdorë, se ka qenë papastër. Në vend se me pastrue, ai ka ndot rrobat ose diçka tjetër të cilët u dasht me e shfrytëzue. Kaptazhat, përveç se që janë bërë në vitin 2022, kanë qenë të planifikuar me u bo në vitin 2023, kanë qenë të planifikume me nja 2 mijë euro më shumë edhe për vitin 2024, ia paskan shtue edhe do pare qetash edhe për vitin 2025, e ku e dish çka ka me ndodhë në 2027-tën, bon vaki kryetari edhe çeshmet ka me na i ndërrue. A po? Mirë, i bjer që kurrë s'kanë me u bo këto, se deri në infinit ka me qenë ky parashikim. Tjetra – e

përmendi z.Ademi, ndriçimi publik, po e shoh në dy lokalitete është ndriçimi publik në qendër të X fshatit. Edhe janë ndara nja 20-30 mijë euro aty, 30 mijë euro për 30 metër katrorë, se qaq i kemi qendrat na nëpër lokalitete të vogla. Aty ka me u bo ndriçim marramendës, ka me shëndrit vendi e s'e di me syza të diellit a kemi me mund me qëndrue. 30 mijë euro për 30 metër katrorë! S'e di, aty nashta hyjnë një pjesë e pareve ta parapara, sidoqoftë. E kemi edhe në qendër të fshatit Brrut, i nderum Gazmend, paskan parapa veç në qendër të fshatit Brrut, aty janë dy Brruta. Ishalla s'ju shkakton më shumë telashe juve të Brrutit, se aty s'dihet te cila qendër kanë me e bo ndriçimin publik. Mandej i kemi disa projekte në fshatin Blaç, unë kam mendue që kanë me fillue ato qetash në vitet 2024-2025, po qysh po e shoh shpresat janë goxha të vogla. Janë projekte të marra kështu në stilin ekzekutiv veç. Këshillat e fshatrave absolutisht nuk janë pyet për këtë çështje. Mundeni me ma dëshmue, me ma përmend një emër të anëtarit të këshillit që e ka bo njërën prej kërkesave këtu. Nuk janë përfillë! Unë besoj që në secilin lokalitet që janë bërë projektet, absolutisht nuk janë përfillë këshillat e fshatrave që na i kemi formue me shumë kujdes edhe me shumë vullnet. Te fshati Blaç e kemi ndërtimi i parkut dhe këndit të lojërave për fëmijë. Fëmijë – qysh po e shoh unë përgjatë kësaj kohës, qaq kemi ikje, s'kemi fëmijë, parqe plot. Kush ka me lujt këtu? Arsyeja pse s'kemi fëmijë, munden me qenë edhe po besoj që është edhe ky nepotizmi, se do prind që s'ju kanë përkrah të atyre fëmijëve, janë të detyruar edhe po detyrohen vazhdimisht me ike prej këtij vendit, se duhet pa qare me qenë pjesë e LDK-së për me u punësue. Kryetar, unë nuk iki, se goxha pushtete s'më kanë bo me ik prej këtu, këtu ke me më pas. Mandej e kemi ndërtimin e parkut në Rrugën “Shkëndija”, në mahallën “Prifte”. Ishalla bëhet, ka qenë i planifikuar edhe vjet. E kam bërë një kërkesë për me e rregullue atë rrugën te Ura e Haxhisë që i themi, aty kohën e fundit kanë dalë qytetarë që po jetojnë edhe banojnë, kanë ndërtue shtëpi. Është mirë kjo me ndodhë, ishalla bare këtë e bëni, se ka shpia pa infrastrukturë në atë pjesën, andej kah Kodra s'kemi qytetarë që jetojnë. Po kaloj te arsimit, këtu te arsimit dhe shkenca i kam parë disa planifikime, po s'ka për vitin 2026-2027 jo, veç s'paskit pas kohë këtu në fund çka me shkruie, e keni lënë përgjys. Nuk ke planifikim për vitin 2026-2027 hiç. Arsimit, është situata e njëjtë me punën e atyre fëmijëve. Ma herët e keni premtue një aneks që ka me iu shtue Gjimnazit “Ruzhdi Berisha”. Unë s'besoj që keni nevojë për aneks, se s'kemi nxënës edhe ai planifikimi për kthimin e nxënësve, moslejimin e nxënësve për me ik, të ka dështue kryetar. Me ua pague dhe bukën tash mo nuk janë duke të ardhë në Dragash, se ka rënë niveli i arsimit në zero. Te arsimit e kemi edhe nuk ka planifikim për diçka që i përket DKA-së edhe arsimit. Është fjala për trajnimin e kurrikulës bazë, që mësuesat e kanë patjetër me e pas kurrikulën bazë. Këtu nuk ke planifikim, qe disa kohë është duke u kërkue për me i trajnue mësuesat për kurrikulën bazë, se është kërkesa themelore për me punue një mësues. E, te trajnimi i kurrikulës bazë, kryetar, është obligim i cili bëhet përmes granteve të veçanta. Nëse mundesh me thënë s'kemi qysh me e bo këtë, kjo është shumë e thjeshtë se bëhet përmes granteve të veçanta. Te shëndetësia s'ka

planifikim, se nuk ka shëndetësi, nuk ka shërbime, për atë s'ka planifikim të nderum kolegë, që pyetet pse s'kanë paraparë. Duhet me pas shëndetësi për me pas planifikim. Fatkeqësisht këtu asnjëra s'është, as shëndetësia e as planifikimi i investimeve më shëndetësi. Faleminderit!

Artan Loshaj: Përshendetje për të gjithë! Unë do të jem pak më i shkurtë se kolegët, për arsye se shumica e diskutimeve u thanë, mos t'i përsëritim. Ky pushtet, për listën e shpenzimeve kapitale 2025-2027, nga 4 milionë e gjys, 2 milionë e gjys ka nda veç kubëzim. Ka ra si pula në gropë! Na kanë kesh PDK-në, e kanë teprue 100 mijë herë më keq se PDK-ja. Për ndriçimin u diskutua, veç shumë thjesht, 20 mijë e 30 mijë veç për në qendra. Ndërsa në vitin e kaluar për fshatin Rrenc, për gjithë fshatin i kemi ndarë 20 mijë euro. Nuk e di pse hala nuk ka dalë ky projekt. Ky projekt është që katër vite edhe kushton 30 mijë euro. Para katër viteve ka kushtue 30 mijë euro, ndërsa sot me 20 mijë euro e keni qit në tender edhe plus nuk ka dalë. Ndërsa, e keni qit projekt dyvjeçar, 70 mijë euro kubëzim. Po më vjen mirë, kryetar, po më vjen mirë edhe pse politikisht nashta mundesh me ma marrë ndonjë votë, po kështu për qytetarët jam i kënaqur, se për rrencjanët edhe ari me iu shtrua unë kënaqem. Problemi tjetër është se – e di kryetari edhe drejtori ku më dhemb mu – te sporti më shumë edhe shëndetësia. Te sporti – tha edhe Nexhmdini shumë shkurt për fshatin Blaç – në mënyrë urgjente kemi ndarë 50 mijë euro, tash po i ndajmë edhe 100 mijë euro, nuk e di ku është gjendja. Ndërsa në atë stadiumit e Dragashit që keni pas dje me e pre edhe shiritin, po për fat të keq vërshimet edhe e keni shty për një afat të pacaktuar. Kryetar, ti e dish shumë mirë çfarë diskutimi kemi pas dje në Komitet. Unë në Komitet diskutoj shumë, po sot do t'i qes me dëgjue edhe qytetarët. Të kam kursye gjithmonë, po sot jo! 220 mijë euro ky Kuvend i ka ndarë në kohën e PDK-së. Në intervista publike ke deklarue që kanë shkue në ujë, kam me ta lëshue videon masnej. 230 mijë euro i keni ndarë ju si pushtet, për stadiumin edhe infrastrukturën. Rugën e ka bërë KFOR-i Turk, e dini shumë mirë. Tepihun e fushës e ka bërë FFK-ja. Çfarë shiriti keni me pre, çfarë merite keni aty, kur asnjë investim s'keni bërë ju? I keni ndarë 185 mijë euro për këtë vit, s'e di çka do të investoni. Gjendja e rrethojës edhe e zhveshtores është shumë e mjerë. Rastësisht një ditë me kolegun u takuam me fëmijët atje, edhe kemi shkue kështu bashkë kemi bërë një inspektim aty, edhe e kam videon. Është gjendja tmerruese, është gjendje e rëndë, ju po pritni shirit! Unë s'e di qysh mundeni me e bo një stadium, një fushë, pa i bo rrethojat e pa e bo zhveshtoren. Sot e kanë përfundue stadiumin, nesër ose masnesër kanë hyrë veturat e qytetarëve të Komunës së Dragashit. Për një muaj ditë, ai stadium në qoftë se shkon në këtë gjendje, me investue FFK-ja për rrethojat edhe zhveshtoren, ai stadium ka me shkue në pikën zero. Ma herët drejtori tha do t'i bëjmë tre punëtorë. Pse nuk i punësoni prej sot me e rujt atë fushën, po po pritni me u prish edhe me dalë në tender a qysh keni me i marrë ata punëtorët. Është mirë, në qoftë se me të vërtetë doni me investue edhe me u mirëmbajt ai stadium, qysh prej nesër në mëngjes duhet me pas roje 24 orë aty, ose kamera. Një postim të drejtorit të Administratës – se Facebook-un e keni marak ju, me dalë nëpër foto, nëpër video – e ka qit një video drejtori i

Administratës e ka postue, kur keni qenë në fushatë me ish-kryetarin Shabani, po nuk e ka çue deri në fund. E ka ndërprerë aty ku ju keni deklaruar që më ka thënë kryetari - qetash kam me e lëshue videon – që janë disa probleme me gjykatat. Mu po më intereson, kryetar, kur e keni ditë që ka problem me gjykatën – unë nuk po them, keni thënë ju vetë, edhe për këtë deklaratë duhet me dhënë përgjegjësi, ti ose ish-kryetari. Keni thënë që ka disa probleme me gjykata. Në qoftë se e keni ditë që ka probleme me gjykata, pse i keni vazhdue punimet mëtutjeshme. Keni investue me Federatën, keni investue ju, keni investue në rrugë...pritsht, kur ka prit KF “Opoja” edhe fëmijët tanë me lujt 7 vite – 4 me ne edhe 3 me ju, 7 – le të pritshin edhe 3-4 vite. Edhe në qoftë se ka pas – dëgjoje deklaratën time – në qoftë se ka pas keqpërdorime, pse i keni amnistue? Ju na keni akuzue publikisht se ka pas keqpërdorime. Një mbikëqyrës të cilin e ka pas PDK-ja, të njëjtin mbikëqyrës e ka edhe LDK-ja në krye me z.Bexhet Xheladinin. Shkojmë në shëndetësi, derisa ta marrim këtë videon këtu. Në shëndetësi pajtohem me parafolësit, se nuk ka asnjë investim. A nuk keni e keni ditë kolegë, që drejtori i Shëndetësisë ka dalë drejtor i Urbanizmit? Atë non stop e keni në kocka, në kubëzime, në kanalizime, atë veç në shëndetësi s’ e keni. Kur kam folë unë për të, ju keni mendue se e kam personale, krejt keni kesh këtu. Sot këqyrne realitetin. Drejtorat të Shëndetësisë nuk kemi na. Bean Hadziasan e dini që nuk vjen as nëpër tubime këtu, as nuk del me dhënë deklarata, i shti me folë Sabahatin, i shti me folë punëtorët. Drejtori i Shëndetësisë merret me kanalizime, kubëzime, foto, video, ju kam pru këtu. Sot shihne që shëndetësia nuk ka drejtor të Shëndetësisë. Për me folë më tepër, për mjekë që tha Urani, më erdh keq që na ofendoi pak për mjekë. Mjekë ka, po këtë do ta foli në eventuale. Po nuk ka analiza, bëhen veç 6 analiza, ma tutje do të foli në eventuale. Një mjek – qe doktor Jetmirin e kemi mjek, edhe kryetarin e kemi mjek – veç për një tension edhe për një kontroll me ardhë te mjeku, çfarë diagnozë mundim me pru, në qoftë se s’ka një pasqyrë të gjakut, në qoftë se s’ka një urinë. Për këtë ma tutje do të vazhdoj. Kryetar, për këtë deklaratën që e keni dhënë në televizor, bashkë me ish-kryetarin, unë jam i fundit me të dëgjue, deri në fund nashta një përgjigje do të na japësh edhe mundësisht, në qoftë se s’kam përgjigje, do të dal edhe një herë atë dyminutëshin me e shfrytëzue. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën nga asambleistët? Në qoftë se jo, nga ekzekutivi a mundeni me iu përgjigj atye pyetjeve që i bënë asambleistët deri tash?

Shpetim Hajredini: E nderuar kryesuese, qe disa herë kemi diskutuar për këtë çështje që mos ta kemi ditën e premte, ta mbajmë seancën. E keni vazhdue njëjtë, nuk kundërshtuam. Kjo është ditë e premte, ditë festë, ne e falim namazin, jena myslimanë. Kena nevojë edhe për me drekue, kështu që tash kërkojmë ta kemi pauzën deri në 13:30, pastaj kthehemi e vazhdojmë seancën siç është më së miri. Tani, në këto momente ne edhe fizikisht nuk jemi më të gatshëm për me vazhdue. Ju faleminderit!

Uran Halimi: Unë po e shoh prej ekzekutivit që s’dojnë me e marrë fjalën edhe s’kanë përgjigje. E argumentojnë edhe faktojnë edhe para qytetarëve që kjo listë e shpenzimeve kapitale është veç sa për

sy e faqe. Pyetjet që ne i bëjmë juve si ekzekutiv, i nderum kryetar, janë pyetje që nuk obligohesh me na dhënë përgjigje neve personalisht si delegatë të Kuvendit, po obligohesh me iu dhënë përgjigje atyre votuesve edhe qytetarëve që ta kanë besue votën, bashkë me ne të VV-së, se të kemi përkrah e mbështet, e të kemi prurë këtu ku je. Andaj, unë pres që juve si ekzekutiv me ju bre ndërgjegjja, edhe me dalë atyre qytetarëve me ua sqarue, me iu dhënë përgjigje për këto paqartësi të shumta që i kanë përcjellë tek ju përmes përfaqësuesve të tyre, në këtë rast përmes neve. Është mirë me dalë me e marrë fjalën, jo veç ekzekutivi, po edhe ju delegatë të LDK-së, edhe ju keni lyp vota për punë, edhe ju duhet me e marrë fjalën me iu kallxue qytetarëve çka është duke ndodhë. Meqenëse ekzekutivi s'ka përgjigje, ju direkt keni lyp vota për këtë ekzekutiv përpara qytetarëve. Dilni, kallxonju qytetarëve çka keni planifikue, çka keni realizue, çka mendoni e pretendoni për me realizue, kur e dimë që zero është. Keni fushatën me rregullim të lumenjve, këta lumenj që po ju shkaktojnë tragjedi sot. Dilni kallxonju qytetarëve, asnjë planifikim për rregullim të shtratit të lumenjve. Edhe kallxonu këtu shumë të papërgjegjshëm përpara qytetarëve. Ne s'përgjigjemi! Duhet me u përgjigj pa qare, se ua keni lyp votën atyre qytetarëve, duhet me mbajt përgjegjësi sot!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Pasi Shpetim Hajredini, shefi i Grupit të PDK-së, kërkoi që Asambleja të mos mbahet ditën e Xhuma, që prej sot unë e jap fjalën që nuk do të ketë më ditën e Xhuma mbledhje të Asamblesë. Pasi disa nga asambleistët kanë bërë shumë pyetje në drejtim të ekzekutivit dhe ekzekutivi nuk do me e marrë fjalën, atëherë unë jam e detyruar ta qesim në votim dhe pastaj të shkojmë në pauzë. Kush është pro Kornizës Afatmesme Buxhetore? A ka kundër? Abstenim? Me 13 vota pro, 12 kundër dhe zero abstenim, e miratojmë këtë pikë. Mua më vjen keq që ekzekutivi nuk ka dhënë përgjigje, por unë nuk jam e detyruar që ata me i qit me zor, por pikën duhet me e qit në votim. Në ora 13:30 kthehemi me pikën e dytë! Faleminderit!

E kemi kuorumin, tash fillojmë me pikën e dytë, që ishte propozimi i disa asambleistëve: Diskutimi për vërshimet që kanë ndodhur në Komunën e Dragashit. Kush do me e marrë fjalën për këtë pikë?

Uran Halimi: Sa i përket pikës të cilëne kërkua, edhe unë jam pjesë e atyre që e kërkua me u fut në rend të ditës kjo pikë. I kisha bo nja dy pyetje, edhe pse bëmë pyetje në pikën paraprake, e s'morëm përgjigje. Hezitova me dalë me pyet se po i bjer që po pyesim e s'po marrim përgjigje, ajo është e pakuptimtë. Znj.kryesuese edhe ju të nderuar kolegë, edhe ekzekutiv, çka është paraparë në lidhje me këtë pikën e rendit të ditës, çka ju si qeverisje keni menduar, cilat janë veprimet që do t'i merrni, të paktën me i evitue pak a shumë, në rast të përmbytjeve, ato dëmet qoftë materiale, apo edhe në aspektet tjera. Është mirë me na dhënë dikush një përgjigje, nëse keni mendue për me formue një komision, cilat janë detyrat edhe përgjegjësitë e atij komisioni, edhe mandej mundim me e hap debatin edhe me diskutue ma detajisht. Faleminderit shumë!

Driton Ademi: Deshta me e pyet kryetarin – edhe ty kryesuese, masi thajë që ka me u formue komisioni

– në komision a ka mundësi për me u përfshi, me marrë pjesë edhe ne si asambleistë, prej opozitës, qoftë një, dy ose sa ta parasheh. PDK, VV, ne të opozitës me marrë pjesë. Asambleistët është mirë me marrë pjesë, Kuvendi. Se përderisa neve munden me na ardhë një vendim për me nda mjete, si Kuvend, atëherë pse mos me marrë pjesë, nëse na lejohet, pse mos me marrë pjesë. Deshta me e ditë a ka me qenë pjesë edhe ndonjë anëtar i Kuvendit në këtë komision, masi edhe në fillim të seancës ju e përmendet që ka me u formue komision. Edhe sa do të jetë ky buxhet, që kryetari me një intervistë ka thënë që ne si Komunë nuk kemi buxhet për mbështetjen e këtyre. Ka kërkue vetëm nga Qeveria qendrore buxhet. Ndoshta në seancat e ardhshme munden me ardhë me e nda ndonjë buxhet prej këtij Kuvendi, është mirë që edhe ne si asambleistë me u përfshi në komisionin të cilin ka me formue qeverisja. Faleminderit!

Uran Halimi: Çka ndërhyra unë, z.Ademi, ti e dish shumë mirë, kur thaje ne të opozitës. Të opozitës jemi veç na qatje tre, katër, po, edhe Sejdlari qenka. Një pjesë e opzitarizmit i takon edhe z.Loshaj, edhe pse, pa të keq, po bëjmë politikë këtu, te kjo pjesa këndeje e di që nuk marr përgjigje. Qe doni, po e bëjmë njëfarë debati kah ana e djathë këndeje, se këta të majtit s’janë t’u dashtë me u përgjigj. Ju Driton, meqenëse keni pas në kohën e juaj vërshime, keni ndarë fonde e buxhet, me m’ngue mu, mos ia kallxo stilin qysh i keni nda edhe ju në atë kohën mjetet. Po s’bën me kallxue, se bëhet lumi në Buzez edhe në fshatrat ku s’ka ekzistue ndonjëherë lumë.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Unë kisha kërkuar nga asambleistët, në qoftë se nëpër media nuk e keni parë rastin qysh ka qenë në Kuk, edhe me ardhë me folë në foltore duke qesh, mu nuk po më pëlqen edhe kjo pikë e rendit të ditës me vazhdue. Ne duhet me ardhë me një përfundim se si t’u dalim në ndihmë, me dalë ekzekutivi me përgjigje. Ne jemi të popullit edhe kur është puna te vërshimet, opozitë edhe pozitë nuk ka këtu. T’isha lut edhe një herë, me u përmbajt në foltore, veç për vërshimet.

Nexhat Selaj: Nuk po mund ta pranoj edhe unë që të merremi me një të kaluar e cila nuk zgjidh problem. Ne e kemi të tanishmen të afërme, të cilët duhet t’u dalim ballë atyre banorëve dhe të jemi krah tyre, që t’u ndihmojmë në ato mënyrat se sa ne mundemi. Edhe në seancat e parahershme, pasi që i përkas këtij profesioni, si punim diplome kam pasur ujërat e territorit të Opojës, se kam qenë një nacionalist, kam dashtë që mundin tim ta harxhoj tek vendi im. Edhe shumë mirë e di rrjetin hidrografik të territorit tonë. Ndoshta po të kujtohet, kryetar, që shumë herët të kam kërkue që të punojmë diçka rreth rregullimit të shtretërve të lumenjve. Juve nëse ju teket, edhe në një tubim kur e keni pasur edhe në territorin tonë, nuk po më kujtohet se ku, në cilin fshat, i keni përmend rregullimet e lumenjve, por edhe në debatet politike, nëpër mjete të informimit keni keni pasur rregullimet e shtretërve të lumenjve. Që nga ardhja juaj, nga viti ’21, ’22, ’23 po edhe ’24 që po mbaron, unë nuk kam vërejtur se ju keni pasur diçka të ngjashme apo të tillë për rregullimet e shtretërve të lumenjve. As sa është më e keqja, nuk po shoh edhe në periudhën ’25, ’26 dhe vitin ’27. Nëse do të jesh si kryetar, unë nuk po shoh se

keni ndonjë projekt për rregullimet e shtretërve të lumenjve. Rret 5.5 metër kub ujë për sekond sjell vetëm lumi i Plavës, që është njëri prej lumenjve që i gravitojnë të gjithë rrjedhat e lumenjve në këtë lumë. E maksimumin e tij ai mund ta arrijë deri në 20 metër kub për sekond gjatë kohërave të vjeshtës kur shtohet intensiteti i reshjeve të shiut dhe gjatë kohës së pranverës kur rritet intensiteti edhe i reshjeve të shiut edhe i shkrirjes së borës. Lumenjtë periferikë që i bashkohen, si lumi i Bresanës, Kukit, lumi i Kosavës, si anë e majtë e rrjedhës, lumi i Dragashit, lumi i Restelicës, më pak sjellin vërshime, këto janë fatale për këto lokalitete të cilat janë të skajuarra përgjatë luginave të këtyre lumenjve. Pikërisht bëhet fjalë për lumin e Kosavës, për ato sipërfaqe, për ato lokalitete, banorë të cilët janë skaj lumit. Po ashtu, të freskët e kemi te lumi i Kukit që patëm disa nga ato problemet, edhe te Bresana, kurse prrocka e Blaçit është pak më e evitueshme. Ne kemi rastin urgjent se këtu duhet të investojmë edhe duhet të veprojmë. Pak më parë, unë e paraqita një kërkesë se a mujm edhe a kemi fond që të krijojmë një fondacion të veçantë për këto raste emergjente, nuk më dhaje përgjigje. Besoj se ke lënë gjatë kësaj pyetjes që të merremi ne me këto pyetje, edhe këtu duhet të diskutohet. Po më intereson të di – neve kryesuesja na ka ftue që sot, në mënyrë kolektive si asambleistë, të shkojmë ta vizitojmë fshatin. Nuk jam kundër që të shkojmë, por çka i afrojmë ne fshatit? Vetëm për me shkue me bo nga një foto atje, ne krejt jemi familjarë edhe kemi miqësi, kemi shkue ndoshta nga dy-tri herë me ato mjetet tona, sa kemi mund me ndihmue , dikush ka ndihmue më shumë e dikush më pak. Bëhet fjalë për punë fizike. Banorëve të këtij lokaliteti u duhet ndihma financiare, se janë shkatërrue, dëmet janë serioze, nuk janë dëmet e vogla. Ne, kryesuese, mund të shkojmë nëse marrim një vendim këtu, çka do t’u ofrojmë atyre që kur të shkojmë si asambleista, shkojmë me një pako të kompletuar le të themi, ne kemi mundur kaq, plus puna fizike vullnetare, sa mundim. Nuk mund të shkojmë vetëm me dalë atje në fotografi edhe t’bëjmë ndonjë selfie, po ua veshim pak më tepër LDK-së së bëjnë selfie, edhe na s’e lëjmë pa të, pa bo. Edhe unë kam marak me e bo një selfie, pasi që ju veç e keni rekordin. Po ne atyre duhet t’u ofrojmë të mira materiale, duhet t’ua zgjatim dorën o sot, o kurrë. Nëse shkojmë ne vetëm me i vizitue edhe me u kthye prapa, unë besoj që në emër timin edhe në emër të GP të PDK-së nuk vijmë asnjë. Besoj se nuk më thojnë jo kolegët. Po nëse shkojmë me një pako që e marrim ndonjë vendim këtu, edhe shkojmë seriozisht shikojmë atje, mund të shkojmë. Kështu që, unë po due me e ditë a është ndërmarrë diçka, a u vendos diçka këtu, a ka mjete, sa mjete do të jenë. Te komisioni është pak më tepër – u diskutua nga kolegët, a munden me qenë edhe partitë tjera prej kolegëve në ato komisionet. Kishte me qenë mirë, s’po di tash a është ligjore apo jo, por ne duhet të jemi krah tyre. Kështu që, mos është pak e vonshme, sot duhet të marrim një vendim, nëse duhet po rrimë pak edhe më vonë, që t’u dalim në ndohmë atyre banorëve të këtij lokaliteti. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Faleminderit zonja kryetare, kemi pasur një stuhi të fortë në komunën tonë, fatkeqësisht dëmet materiale si në pronë shoqërore ashtu edhe në pronë private ende nuk janë vlerësuar,

por janë në përmasa të mëdha, mirëpo fatmirësisht nuk ka pasur dëme me fatalitet. Faleminderit Zotit të gjithë janë gjallë dhe shëndoshë në komunën tonë, njëkohësisht shfrytëzoj rastin të falënderoj të gjithë ata që dolën në terren dhe takuan qytetarët që u përballën me këtë fatkeqësi natyrore, megjithatë çfarë më befasoi dhe nuk prisja nga pse nuk e shpallët gjendjen e jashtëzakonshme në komunën tonë në atë ditë fatale kur ishte tragjike për sa i përket faktorit njerëzor. Me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në komunën tonë, hapim rrugën ligjore që çdo dëm t'i kalojë vetë komunës dhe i hapim rrugë komunës që të kërkojë donacione si nga qeveria ashtu edhe nga faktorë të tjerë, pra. se ne mund t'i ndihmojmë njerëzit në nevojë në komunën tonë sa më lehtë dhe sa më mirë. Mendoj se edhe sot në këtë seancë mund të shpallim gjendjen e jashtëzakonshme, të vendosim për këtë çështje dhe çdo dëm që i bëhet çdo qytetari të komunës sonë t'i faturohet komunës, në terma popullore, atëherë Komuna i hap rrugën vetes për të kërkuar donacione dhe ndihmë nga qeveria dhe faktorë të tjerë, komuna po i hap rrugën vetes që të mos merret me projektet që janë planifikuar për vitin 2024, sepse fatkeqësisht tani kemi fusha që janë të shkatërruara. , ne nuk mund të bëjmë projektet që kishim parashikuar në ato fusha kurioze sa ato fusha ishin të shëndetshme. Më vjen shumë keq që kjo ndodhi, megjithatë, zonja dhe zotërinj, të nderuar qytetarë dhe kolegë këshilltarë, është vullneti i Zotit, kur diçka vjen nga Zoti, mund të themi se është e mirëseardhur, dhe nga e dimë se për çfarë është e mirë, ne thjesht duhet të rishqyrtojmë sjelljen tonë, të rishikojmë gjendjen e shpirtit tonë, se ne si popull nuk kemi bërë diçka të keqe, ndaj Zoti vetëm po na paralajmëron. Tjetër, zonja kryetare dhe të nderuar kolegë këshilltarë, kryetar komune, dje kemi pasur një komision për komunitete, zoti Samidin Xheladini është dëshmitar i gjallë për mua se kemi marrë një vendim në atë komision ku kemi rekomanduar që kuvendi ta fusë këtë pikë në rend dite. . Falënderoj të gjithë sot që e mbështetën këtë pikë, megjithatë, e kam vërtet të vështirë të pranoj që ne e vendosim KAB-në përpara kësaj pike. Kjo dëshmon se realisht në Kuvend, as pushteti ekzekutiv nuk është aq i interesuar për qytetarët. Fillimisht diskutuam për BAK-në, e më pas diskutuam pikën e fundit para problemeve eventuale me të cilat janë përballur banorët e fshatrave tona dhe qytetarët e komunës sonë gjatë gjithë këtyre ditëve me mot të keq. Tjetër, në komisionin për komunitete kemi bërë edhe një propozim që të kërkojmë nga kuvendi të formohet një komision, komisioni kuvendor do të dalë në terren për të vlerësuar dëmin dhe i cili do të kujdeset që brenda kornizës ligjore dhe si t'i takojmë sa më shpejt dhe sa më mirë të prekurit me qytetarët e komunës sonë të cilët kanë pasur dëme të shkatëruara nga stuhia. Duke qenë se territori i komunës sonë është i gjerë, ne në kuvend mund të ndahemi në dy, tre ose pesë grupe, që në kohë sa më të shkurtër të dalim në terren dhe të shohim se çfarë dëmi është bërë, si në pronën publike ashtu edhe në pronë private e qytetarëve tanë, e bërë brenda grupit të punës, dhe mendoj se të gjithë duhet t'i qasemi seriozisht këtij problemi, t'i zgjidhim sa më shpejt problemet e qytetarëve tanë, t'u sigurojmë atyre kushte sa më normale për jetë të mëtejshme. E treta, zonja dhe zotërinj, i nderuar kryetar komune, ky është një

shembull tjetër që ju e keni marrë seriozisht realizimin e investimeve kapitale dhe projekteve, e ndoqa deklaratën tuaj nëpër media dhe deklaratat e qytetarëve që ankoheshin se komuna ka bërë punë katastrofike në kanalizime dhe shtretërit e lumenjve. Duhet të shikohet më seriozisht se si operatorët ekonomikë i marrin tenderët dhe si e kryejnë punën në terren. Ju lutemi kushtoni vëmendje kur punohet në terren. Propozimi im është që tani të shpallim gjendjen e jashtëzakonshme dhe të formojmë komisione që do të hetojnë dëmet e shkaktuara nga përmbytjet.

Jetmir Ajdini: Lidhur me situatën e krijuar pas vërshimeve të cilat ndodhën në fshatrat tona, e para e udhës do të ishte formimi i një komisioni për vlerësimin e atyre dëmeve të cilat u janë shkaktuar familjeve të prekura nga vërshimet, qoftë nga Kuvendi qoftë nga ekzekutivi, komisioni i cili do të bëjë vlerësim real të dëmeve të shkaktuara nga vërshimet. Tjetra çfarë mund të bëjmë na është një kërkesë zyrtare Qeverisë, edhe pse Kryeministri Kurti ishte në vizitë dhe e pa gjendjen nga afër. Një kërkesë zyrtare Qeverisë, për ndihmë financiare direkte, sikurse qysh u janë ndarë komunave tjera kur kanë pas problem me vërshimet, edhe neve të na ndahet një fond, që Komuna ta përballojë shumë më lehtë atë problem që na ka ndodhë për shkak të atyre vërshimeve. Më e lehta është me dalë edhe me u thënë qytetarëve që Komuna nuk ka buxhet, edhe Komuna nuk mund të bëjë thjesht asgjë për me iu dalë në ndihmë. Gjithsesi, edhe nga Komuna do të duhet të ndahet një fond, sado që të jetë ajo shumë, për me i përballue qeto probleme elementare që janë, fillestare, e mandej kur të bëhet vlerësimi i dëmeve të kërkohet nga Qeveria saktësisht sa është vlera dhe të kërkohet vlera e saktë e rimbursimit të atyre dëmeve. Tjetra çka duhet të bëjmë ne, është intervenim urgjent në shtretërit e lumenjve, që ta parandalojmë një fatkeqësi të dytë, e cila mund të ndodhë përsëri. Intervenim në ato vende ku janë pika rreziku ku lumi mund ta kalojë shtratin; intervenim në ura, ku janë të ngushta të zgjerohen, e të gjitha ato. Ju faleminderit!

Shpetim Hajredini: Natyrisht, në fillim të kësaj pike të cilën edhe personalisht e kërkova ta kemi, falënderoj Zotin i cili nuk na dënoi me një dënim të tillë i cili do të kishte pasur mundësi që sot të kemi edhe viktima. Po e shfrytëzoj këtë mundësi edhe t'i falënderoj të gjithë ata qytetarë, sidomos bashkëfshatarët e mi të cilët nuk hezituan dhe dhanë maksimumin e tyre që t'u gjenden pranë atyre familjeve të cilat ishin më të rrezikuara nga kjo fatkeqësi. Gjithashtu, falënderoj personalisht dhe në emër të gjithë fshatit Kuk, kompanitë private të cilat e bënë maksimumin e tyre dhe erdhën u gjenden pranë nesh, dhe na ndihmuan aq sa patën mundësi që ta kalojmë këtë sfidë apo këtë rrebesh të shiut i cili erdhi nga lart. Unë qysh në fillim, në këtë pikë të rendit të ditës do të kisha diskutue edhe për komisionin dhe nuk po e di tash saktë nëse dikush – me përjashtim të Jetmirit që e dëgjova, që e dha si propozim – nëse ka pasur dikush prej jush që ka propozuar që edhe ne si Asamble apo legjislativ të jemi prezentë në këtë komision, apo të marrim pjesë edhe ne, ta përfaësojmë komisionin i cili do bëjë vlerësimin e dëmeve të cilat janë shkaktuar nga vërshimet. Unë e di se ne nuk jemi, personalisht as unë,

po edhe këtu ndonjëri nuk e di që është inxhinier dhe që merr vesh në këtë drejtim, po kisha kërkue që, së paku, ne të jemi në vëzhgim apo të marrim pjesë dhe të shikojmë se si po rrjedh dhe si po vlerësohen dëmet të cilat janë shkaktuar nga qytetarët. E di personalisht mirë, e kam lexue edhe ligjin që nuk paraqet kurrfarë problemi që ne të jemi pjesë e këtij komisioni. Nuk besoj që edhe ekzekutivit i paraqet problem që edhe ne si legjislativ të jemi pjesë e këtij komisioni. Unë jam i bindur që do të ishte vetëm në të mirën edhe të ekzekutivit, po shumë më mirë do ishte edhe për qytetarët, pasi ne jemi përfaqësues të tyre. Komisioni është formuar, me sa e kuptuam nga ana e ekzekutivit. Kisha pas dëshirë që kryetari të na japë një informacion, prej sa personave është formuar ky Komision, dhe pastaj natyrisht që do diskutojmë dhe do bëjmë propozimin tonë që edhe ne të jemi dhe të marrim pjesë në këtë Komision, si legjislativ, me tre apo katër, sado që na lejon ligji, të jemi pjesë e këtij Komisioni. Por, një herë së pari dua ta marr përgjigjen prej kryetarit, prej sa anëtarëve është, dhe pastaj do vazhdoj dhe do jap propozimin e PDK-së, dhe natyrisht edhe partitë tjera të cilat duhet të jenë pjesë e këtij Komisioni do të japin emrat e tyre. Nëse kalon propozimi, mirë, nëse nuk kalon, ne nuk mund të dalim jashta asaj që na lejon ligji. Ju faleminderit!

Artan Loshaj: Ma herët u diskutua që do të formohet komisioni. Edhe unë jam i interesuar si asambleist me ditë, prej sa vetave do të formohet edhe a do të ketë një komision edhe nga ekzekutivi, edhe nga Kuvendi. Ne nuk duhet me bo politikë këtu, se ata qytetarë nuk janë as të PDK-së as të LDK-së, janë qytetarë të Komunës së Dragashit. Nuk duhet të rrimë duarkryë. Mu po më intereson – se kryetari e ka dhënë një deklaratë në RTK prom, që ka thënë Komuna nuk ka mundësi t’u ndihmojë. Dua një përgjigje prej kryetarit, a mundim me ndihmue edhe sa, jo me thënë s’mundim. Sa kemi mundësi, 100 mijë 100 mijë, 200 mijë 200 mijë, 1 milion, sa të duash, se ka shuma të mëdhaja aty që janë bo dëm. Po më intereson takimi me Kryeministrin Kurti, qa ka qenë prezent këtu, a kanë bisedue për këtë çështje, a kanë biseduar, a ka lyp ndihmë nga Kryeministri Kurti, sa ndihmë ka lyp edhe sa ndihmë mund me dhënë kryeministri. Edhe, m’u dok e ngutshme në pikën e parë të kalojë Korniza Afatmesme Buxhetore. Unë si asambleist – po ajo kaloi edhe përgjigje nuk morëm nga kryetari dhe nga ekzekutivi – pse të kalojë pikë e parë e rendit të ditës, pse mos të diskutohet për këtë. Edhe, i kemi mbi 4.5 milionë euro për vitin 2025 për investime kapitale, pse një shumë mos me mund me e nda prej tyre për këtë gjendjen e jashtëzakonshme. Ku kemi rrit qe 25 vite mas luftës pa kubëzim ose pa ndriçim, mundim me rrit edhe për një vit. E di që kryetari thotë kjo nuk bëhet, munden me u bo, se vitin e kaluar kemi ndarë afër 1 milionë euro për 15 fshatrat ujin e pijshëm. E di që ka qenë prioritet, po besoj se kjo është edhe më prioritet, se qytetarët kanë pësuar dëme të mëdha, ndaç në prona private, ndaç shoqërore. Andaj unë e kam një propozim, që në qoftë se nuk ka mundësi Qeveria të ndihmojë edhe Komuna, deri në shtator kur bëhet miratimi i buxhetit për 2025-tën, të merret një shumë nga buxheti edhe të investihet në këto fshatra, në këto shtëpia private të Komunës së Dragashit.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Atëherë nëse nuk do askush, derisa ta marrë kryetari i Komunës fjalën, unë po atë ditë kur e kam marrë vesh që vërshimet janë lëshue në fshatin Kuk, deri në 19:00 në mbrëmje kam qenë në punë dhe prej punës kam ec drejt fshatit Kuk. E kam kontaktue z.Shpetim Hajredini si shef, se është prej atij fshati, i kam thënë që me dalë me e takue edhe atë. Nuk kanë bo valët, po ma vonë e ka pa, masi i kam vizitue të gjitha fshatrat – në emër të Kuvendit i kam vizituar ato fshatrat, pa e thirrë as kryetarin as kërkond, veç në emër të Kuvendit të Komunës së Dragashit. Shpetimi më është lajmëruar diqysh më vonë, kur i ka mbërri mesazhi atij, por kjo s’do të thotë. Unë atë natë kam marrë pjesë deri në 23:00 të natës dhe kam qenë në fshatin Kuk, pastaj i kam vizitue të gjithë fshatrat që janë prekur në atë pjesë. Do t’ia jap fjalën edhe kryetarit, unë deshira në emër të Kuvendit ta falënderoj kryeministrin e Kosovës, që ka pas gatishmëri edhe që ka ardhë na ka vizituar, edhe ka qenë shumë i qartë edhe shumë i prerë. Për komisionin që do të bëhet në Asamble, unë kam qenë dje në Shtabin e Emergjencave që u formua, po edhe aty MAPL-ja ka kërkuar që kryetarja të jetë edhe anëtare e Shtabit, qysh i takon me ligj, por këtë prapë do të thotë kryetari. Unë zyrtarin ligjor e kam afrë, do ta pyes qysh është me ligj, jashtë ligjit nuk do të shkojmë. Do t’i shohim anët ligjore qysh do të jenë edhe do ta marrim një vendim. Kështu që, e lus kryetarin që të jap më shumë hollësi rreth kësaj ngjarje që na ka prek, edhe shyqyr Zotit që s’ka prek në njerëz. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Faleminderit, kryesuese! Të nderuar asambleistë, më lejoni që përmes kësaj foltoreje t’i drejtohem edhe një herë opinionit publik dhe qytetarëve lidhur me situatën e krijuar që nga momenti i fillimit të vërshimeve deri më sot. Do ta jap një informatë – edhe pse këto informata ju sigurisht i keni përcjellë dhe i dini, po me i përsërit - repetitio est mater studiorum – përsëritja është nëna e mësimave. Më vjen mirë që ju pozita propozuat që sot, si pikë e veçantë e rendit të ditës të jetë situata e krijuar pas vërshimeve. Unë si kryetar, edhe kryesuesja, para se me ardhë këtu, jemi marrë vesh që në kuadër të pikës eventuale të debatohet edhe për këtë çështje. Nuk është ligj, as rregull e shkruar, por është mirë që kur të propozohet rendi i ditës dhe i dërgohet materiali Qeverisë edhe MAPL-së, është mirë që të mbahet renditja, mos të prishet. Pastaj, nuk është me rëndësi a është pikë e parë a e dytë, po është me rëndësi që me u debatue. Më vjen mirë që m’u dha rasti t’ju drejtohem edhe juve, dhe ju garantoj se nga momenti kur kanë filluar vërshimet, unë kam pas kontakte telefonike me kryesuesen, e cila ma ka mundësue që të bëj një telefonatë me drejtoreshën e Shërbimeve Publike të Prizrenit. Kam marrë informacione që më kanë vyjt mu. Pas asaj, e kam thirrë drejtorin e Shërbimeve Emergjente në nivel të Kosovës, z.Abdullahu – është personi kompetent që i menaxhon këto situata në nivel të Kosovës. Kam marrë edhe prej tij të dhënat që unë i kam dëshirue. Pastaj, Pastaj, e kam thirrë në telefon kryeinspektorin e AME-së, z.Kastriot Lajqi. Pas atij, kam bisedue edhe me ministrin e MAPL-së, z.Elbert Krasniqi. Pas kësaj, pasi i kam pas informatat e duhura se çka duhet të bëj unë si kryetar i Komunës - për arsye se është fat i mirë që nuk kemi këso raste të shpeshta, edhe normal unë

kur nuk di, pyes, për mos me e shkelë ligjin, edhe nuk më vjen kurrë turp unë me pyet edhe nga dikush që është i nivelit më të ulët se unë. Të gjitha gjërat nuk muj me i ditë. Atëherë kam fillue me i thirrë rend kompanitë private të cilat kanë ekskavator. Jo vetëm unë, po i kam angazhue edhe drejtorët që secili, kah ka njohuri e njoftësi t'i thirrin ata. Pasi i përmenda këta, shfrytëzoj rastin që t'i falënderoj të gjitha kompanitë të cilat kanë marrë pjesë dhe që janë edhe sot në sanimin e gjendjes. Do t'i përmend me rend: Kompaninë "Behari" – Blaç, NIKI GD, PUNA Sh.P.K., Universal Comerc, TAKOS – Bellobrad (nuk ia di emrin këtij djalit të Bellobradit, më fal!), s' di a ka kompani a jo, por ekskavatori i tij ka bo një punë të shkëlqyeshme në Kuk, pastaj "Marashi" – Kuk, "Vllaznimi"- Shajne, Ajdin Milazim Halimi nga fshati Kuklibeg. Gjithashtu, dua ta falënderoj edhe "Ekoregjionin" i cili qe dy ditë është duke na ofruar cisterna për pastrimin e rrugëve, edhe sot kemi dy cisterna, dje i kemi pas tri, të cilat tri herë në ditë janë mbush. Gjithashtu, edhe "Hidroregjionin Jugor" i cili na ka ofrue cisternën për zhbllokimin e kanalizimit në fshatin Kuk, por për fat të keq s'kemi mujt me e zhbllokue. Kështu që, unë si kryetar i kam ndërmarrë të gjitha masat ligjore që mund t'i marrë një kryetar. Pastaj, ju si Kuvend nuk keni qenë të anashkaluar. Kryesuesja na u ka bashkangjit në Kuk, dhe kemi vazhdue i kemi vizitue të gjitha fshatrat. Ajo ka ardhë na ka gjet neve aty, mua dhe një pjesë të qeverisjes. Pastaj kemi shkue në Kosovë dhe në fshatrat tjerë. Kështu që, ju si Kuvend e keni kryesuesen edhe ajo ju përfaqëson juve në emër tuajin, sikur unë që jam kryetar në emër të qytetarëve të Komunës së Dragashit. Kjo është sa i përket ditës së parë të vërshimeve. Ditën e dytë, në mëngjes e kam thirrë Kastriot Lajqin, kryeinspektorin, njëherit është edhe kryetar i Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve, në nivel qendror. Janë dy arsye pse e kam thirrë: E kam lut që të vijë në mbledhje të qeverisë, të asistojë, që kur ta formojmë Komisionin të mos bëjmë ndonjë gabim, se gabimi na kushton pastaj me kohë. I kam thënë merr edhe ndonjë anëtar tjetër të Komisionit dhe ai e ka marrë një anëtar, z.Bashkim Mehmetaj, është përfaqësues i Komisionit Qendror për Vlerësimin e Dëmeve nga Ministria e Financave. Gjithashtu, kam biseduar edhe një herë me ministrin e MAPL-së, nga i cili kam marrë njoftimin se do të na vizitojë edhe Albin Kurti. Me kënaqësi e kam pranue këtë lajm dhe i kemi bërë të gjitha përgatitjet që ta presim. Gjithashtu, dje na ka vizitue edhe kryeshefi i "Hidroregjionit Jugor", z.Fadil Berisha. Dje gjithashtu kam pas takime me KFOR-in Italian, me Komandën e KFOR-it Italian i cili është përgjegjës për sigurinë e gjysmës së Kosovës, pjesës perëndimore. Përveç që ia kam përshkruar gjendjen, kam kërkuar edhe ndihmë. Zv/komandanti më ka thënë që do ta shqyrtojë këtë kërkesë të juajën për ndihmë. Gjithashtu, kam kërkuar edhe nga KFOR-i Turk, i cili ka qenë dje në vend të ngjarjes, i ka vizitue zonat dhe presim përgjigje nga ta. Na ka vizitue edhe drejtori i Policisë së Kosovës dhe komandanti i Stacionit Policor në Dragash. Kryeministri Kurti së pari më ka vizitue në zyrë, ia kam përshkruar gjendjen e krijuar, dhe pastaj unë kam kërkuar një shumë të caktuar të mjeteve urgjente për sanimin e dëmeve që janë shkaktuar në infrastrukturë rrugore, ujësjellës, kanalizim, mure mbrojtëse dhe ura. Ndërsa, sa i

përket dëmëve që janë shkaktuar në ekonomi familjare, në biznese, në bujqësi, blegtori etj., ne kemi formuar Komisionin Komunal për Vlerësimin e Dëmeve. Gjatë punës së atij Komisioni ka marrë pjesë edhe kryesuesja e Kuvendit dhe këta dy personat, Kastriot Lajqi e Bashkim Mehmetaj, ku unë si kryetar i Komunës, duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, si dhe Rregulloren për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera, duke u bazuar edhe në këshillat që na i ka dhënë Kastriot Lajqi, kryetari i Komisionit Qendror, unë si kryetar i Komunës i kam propozue emrat e anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve, bashkë me Qeverinë Komunale. Komisioni është formue prej pesë anëtarëve, sot ai ka dalë në vendngjarje, ka fillue punimet. Kryetar i Komisionit është Florim Krasniqi, me të cilin unë nga viti 2000-2007 kam pasur një bashkëpunim të mirë, është një ekspert i fushës për të cilin unë kam propozue që ai të jetë kryetar i Komisionit. Kështu që, unë nuk e di edhe në çfarë partie është. Unë e kam propozue Komisionin në bazë të ligjit edhe ka aty përfaqësues edhe nga komuniteti joshumicë. Ky Komision ka dalë sot në vendngjarje, e ka bërë vlerësimin e dëmeve në infrastrukturë në fshatin Kuk dhe fshatin Kosavë, ndërsa nesër do të bëjë në fshatrat Bresanë, Blaç, Zaplluxhe, Pllajnik dhe në tri-katër familje të dy-tri fshatrave tjerë, ku kemi marrë informata se ka dëme. Gjithashtu, një pjesë e Komisionit ka shkue edhe në familje, ka fillue mbledhjen e informatave për dëmet në ekonomi familjare. Kryeministri Kurti, pas vizitës që e ka bërë te unë në zyrë, kemi shkuar në Kuk. Unë me qëllim e kam çue në fshatin i cili është më i dëmtuar, dhe aty para gazetarëve prapë ka kërkuar ndihmë financiare urgjente. Ndërsa, sa i përket ndihmës financiare për kategoritë që i përmenda, Komisioni do ta vlerësojë, për secilin person do ta bëjë nga një dosje, me dëshmi, me fotografi dhe video, do ta bjer në Asamble Komunale. Asambleja Komunale ka me e votue këtë Raport të Komisionit. Pas miratimit, ky material ka me shkue te Komisioni Qendror për Vlerësimin e Dëmeve, i cili pastaj ia dërgon Qeverisë për pagesën e dëmeve. Nga dikush u tha se unë kam thënë që Komuna nuk ka pare për me i pague dëmet e vërshimeve. Unë kam thënë që ne si Kuvend Komunal nuk kemi mundësi financiare për me i mbulue shpenzimet, për arsye se edhe me ligj, dëmet që vijnë nga fatkeqësitë natyrore, kompetent për pagesën është Qeveria qendrore. U tha nga këtu se pse ne nuk vendosëm që të ndajmë mjete për sanimin e gjendjes, duke u bazuar në KAB. Ju e dini që KAB-i është kornizë e cila është përgatitje, nuk votohet këtu për mjetet të cilat na duhen shpejt, por këto mjete votohen për vitin e ardhshëm. Asgjë nuk na gjë neve, që nëse Qeveria nuk bënë asgjë, këto mjete t'i orientojmë në këto projektet të cilat u diskutuan këtu, që janë problematike. Po megjithatë, unë e kam një bindje se Kryeministri Kurti ka me nda mjetet të nevojshme për sanimin e dëmeve që janë shkaktuar që janë shkaktuar nga vërshimet në infrastrukturë rrugore, pa i prit procedurat e Komisionit. Unë kërkesën do t'a dërgojë të hënën, sepse pres edhe vlerësimin që do ta bëjë edhe për ato tri fshatrat që i përmenda, dhe pastaj e kam një bindje që Qeveria Kurti do ta na ndihmojë. Unë do të kërkoj nga ai që me procedura të përshpejtuara t'i gjejmë kompanitë të cilat do të

merren me sanimin e kësaj gjendjeje duke u bazuar në çmimet të cilat i ka Zyra e Prokurimit, ku kompanitë e ndryshme kanë marrë punime në bazë të çmimeve që i kemi qit në tender. Kjo është edhe e lejuar, ne mund ta bëjmë këtë gjë. Nuk e di a i mbeta dikujt borxh, por ne u akuzuam si qeveri komunale pse nuk e kemi bërë pastrimin e lumenjve. Unë të thashë, investimet kapitale, ne si Qeveri Komunale i bëjmë në bazë të kërkesave të qytetarëve, që i bien fshatrat, këshillat e fshatrave etj. Por, mirëmbajtja e lumenjve nuk varet prej qeverisë dhe prej pushtetit. Duhet edhe qytetarët, sepse sipas mendimit tim vijnë nga dy faktorë, faktori Zot, dhe faktori shtrati i lumit. Zoti është falës edhe falen, edhe kur ka vendos me ra breshër, ka vendos me ra ditën e jo natën, ku ka mund të ketë edhe viktima, pra Zoti ka vendos që mos të kemi viktima. Ndërsa lumi edhe shtrati ka vendos të na dënojë, për arsye se ne si qytetarë nuk jemi të vetëdijshëm, edhe unë si qeveri, se lumenjtë duhet të mos i zaptojmë, t'i mirëmbajmë, të mos gjuajmë mbeturina, jorgana, dysheka, kauqa etj. Shtratin e lumit duhet ta mirëmbajmë. Ne do ta bëjmë një pastrim të lumenjve, do ta bëjmë zgjerimin e shtratit. Por te ky vërshim i para tri ditëve nuk ka qenë faktor vetëm pastërtia e shtratit të lumenjve, por kanë qenë urat, të cilat – më vjen keq – janë ndërtue duke qenë ju në qeveri, të cilat i keni ndreq sa kutia e çibritit. Unë kur e kam marrë pushtetin, i kam urdhërue hartuesit e projekteve që të gjitha urat që i bëjmë ne, t'i bëjmë ura të mëdha. Edhe kemi na tash shembuj, muj me i përmend, qato urat që i kemi ndreq ne, e kanë shpëtue Zaplluxhen, e kanë shpëtue një pjesë të Kosavës. Prandaj, mod u mundohnu me e qit fajin, unë nuk dashta fajin me ia qit kërkuj, por arsyeja pse kanë ndodhë vërshimet në Kuk edhe në Kosovë, janë urat sa kutia e çibritit. Vërshimet e Kukit, është bërë bllokimi i urës nga pjesa lindore e fshatit, dhe pastaj lumi i ka përfshirë rrugët dhe ka bërë dëme të pariparueshme, po shyqyr Zotit, në këtë fatkeqësi Zoti ka vendos që të mos kemi viktima. Unë nëse kam harrue dikujt me i dhënë përgjigje, prapë do të dal, do t'ju jap përgjigje, por për sa i përket përgjigjeve që nuk jua dhamë për KAB-in, unë si kryetar i Komunës kam kërkue nga drejtorët që të mos dalin me ju dhënë përgjigje, por këto përgjigje do t'i merrni në pikën eventuale. Arsyet janë dy: e Xhumaja, se vetë kërkuat që të thirret pauza, të shkohet në Xhuma, sepse po të kishim dalë ne me dhënë përgjigje do të zgjatej Asamblejal; edhe e dyta është që sot ne është dashtë patjetër kopjen fizike, Vendimin ta çojmë në Ministrinë e Financave si KAB të miratuar. Falë Zotit edhe juve, KAB-i u miratua, vendimi i nënshkruar nga kryesuesja dhe ZKF është nisur për Prishtinë me e dërgue KAB-in. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: I nderuar kryetar komune, arsyeja pse drejtorët nuk kanë dhënë përgjigje është se ju gjithmonë nuk i keni votat për të kaluar KAB pas pauzes. Shihni sa këshilltarë keni në krah. Mos na kaloni këtu pataten e nxehtë, sikur të ishte faji i delegatëve tanë që bënë pyetje për kornizën buxhetore afatmesme. Arsyeja e vetme pse nxitua dhe nuk lejuat drejtorët dhe askënd në ekzekutiv të na përgjigjen për çështjen e KAB-së është se nuk keni vota asnjëherë pas pauzes për të marrë ndonjë vendim. Ju nuk mund t'i mblidhni këshilltarët tuaj në bankat tuaja të këshilltarëve. Këtu, numëroni sa

nga pozicionet tuaja janë aktualisht të pranishme në seancë. Dinjiteti nuk të lejon të ma hedhësh fajin mua, sepse unë bëra pyetje, se nuk do të kesh vota pas pushimit, nuk ishte problem, mund të vazhdonim punën në orën 01:30. Ju nuk keni vota pas pushimit. Ky është fakt, do të doja t'i kërkoja zotërinjve nga mediat të shohin se sa prej jush jeni të pranishëm në banka. Ne jemi këtu për të bërë pyetje, për të kërkuar detaje, dhe ju jeni këtu për të na dhënë një përgjigje dhe në fund për të votuar. Tjetër gjë zoti Kryetar, pse rrezikuat atë ditë, sepse asnjë faktor njerëzor nuk mund të parashikojë se çfarë mund të bëjë Zoti, e patë që situata në terren ishte katastrofike, se lumenjtë u derdhën, se kanalizimet u bllokuan, se gurët ishin në rrugë, quajtën ato kompani që u përgjigjën, të cilave edhe unë personalisht i falënderoj për ndihmën që dhanë. Ke rrezikuar të mos shpallesh gjendjen e jashtëzakonshme, duhet të kishe shpallur gjendjen e jashtëzakonshme, kështu që ne ndihme ka ardhur edhe ushtria dhe institucionet e tjera kompetente, dhe jo vetëm ti me çizme të shkosh atje, me shume bere telash se sa ndihme. ata qytetarë atje. Me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme i hapim rrugë bashkisë, kështu nuk kemi asnjë gjendje të jashtëzakonshme, nuk kemi asnjë lloj argumenti të vështirë për të kërkuar që të na jepin donacione për të riparuar. dëmin e qytetarëve tanë dhe dëmin e bërë në pronën publike. A do të formojë Kuvendi komision parlamentar për këtë çështje?

Driton Ademi: Disa pyetje për kryetarin, nëse ka mundësi! Kryetar, thajë që kam pas kontakt me KFOR-in Turk edhe Italian – mos gabofsha. A kishte qenë e udhës, meqenëse ata kanë goxha makineri të rëndë që mundën me ndihmue në pastrimin e lumenjve, kishte qenë mirë kërkesën për ta, me kërkuar nga makineritë të cilat i kanë, për pastrimin e lumenjve. Edhe e dyte, kryetar, unë e di që ka bërë më shumë dëme në Kuk, por edhe në Bresanë ka bërë shumë dëme, edhe në shpia edhe në rrugë edhe në shumë vende. Pse në Bresanë disa projekte edhe në qeverisjen tënde nuk janë krye në mënyrë të rregullt, që ke dalë më ke akuzue edhe mu për projekte. Dje ka pas thujse gati edhe përleshje, pse po i del në arë e ka qenë t'u ia marrë shpinë. Shumë mirë e dish, te pjesa që është kah Blaçi, ai projekt nuk është përfundue tamam, edhe dje ka mund me has edhe në përleshje fizike. Tash nëse llogaritet ma mirë 200 balla me të shkue dëm, a ma mirë me të shkue një shpi 50-60 mijë euro dëm, unë nuk e kuptoj, njerëzit nuk po e kqyrin me kuturis një jetë, po po i këyrin ballat a i kanë shpëtue. Unë pres prej teje që me përfundue ai projekt, ta kesh parasysh që duhet me përfundue, mos me e pyet kërkond, se kur është në interes të qytetarëve, unë mendoj që nuk duhet me pyet as Dritonin, as Bexhetin, as kërkond hiç. Për ma shumë e di edhe Meni, se ka qenë edhe dje prezent, e ka pa sa dëme ka bo edhe te miku i tij aty. Shumë ligësi është me dalë edhe me akuzue për gjëra që s'ia vlen, kurse mundën me shkue jetë njerëzish. Faleminderit!

Nexhat Selaj: Me plot vëmendje të përçolla, kryetar. Deri në atë fazën e fundit ishe shembullor, që kam qef gjithmonë me të dëgjue kështu, që pak herë të bën vaki edhe rrish vonë, po edhe sot që rrite pak në fund e prishe. Ti je kryetar, jo me dhënë akuza çfarë kanë bërë qeveria paraprake tjetra, ti ke

ardhë kryetar prej mandatit të asaj kohe, tash çfarë do të bësh. Vetë je deklarue se do të punojmë për pastrimin e lumenjve. Nëse është bërë një pastrim i një lumi, del më thuaj cili, unë do të tërhiqem, do të kërkoj falje. The se janë ndërtuar urat nga qeveria juaj. Unë me sa e di, ura në fshatin Kuk i takon viteve të '50-ta, edhe nuk di aty që ka pas ndonjë intervenim, te ajo. Ishte humë e arsyeshme që the fuqia natyrore e bën të veten, me atë pranohe mi ne, po që të sulmosh tash pse s'kanë bërë ata. Unë tash po të akuzoj: E ke pas në projektin tuaj qeverisës si deklaratë se do t'i pastrojmë lumenjtë. Cilin lumë e ke pastrue? Nëse ke pastrue një lumë, trego bile ta dimë, të japim duartrokitje. Unë e kuptoj se pastrimet e lumenjve janë shumë të shtrenjta, por ta fillojmë një herë bre kryetar me këtë qeverisjen tuaj, masi qeverisja e PDK-së nuk e ka bërë. Të fillojmë me qeverisjen tënde 100 metër t'i bëjmë, dhe ta shohim se sa lehtë do t'i harxhojmë lumenjtë me shtratin e lumit. Edhe shtrati është sikur njeri, kryetar. E akuzove për urën e viteve '50-ta, po thuesh nga vendi se është bo ma vonë. Okej, shumë në rregull është. A e ke vizitue urën në fshatin Qollopek që vetë e keni rregullue edhe keni investue, a ke dalë me pa çfarë tmerrri është, kryetar? Ka qenë në projektin zhvillimor në 2023 të mbarohet. Jo që nuk e ke mbarue, po e ke shkatërrue të tërrën, për kur do ta bësh të gatshme atë rrugë? Po të vish t'i shikosh ti, si në kohën e Mesjetës, nëpër lumë akoma bartin me shtaga, dikush i thotë me lesa, e bartin barin nga ana e lumit në pjesën e bregut. Është prish edhe rruga e cila ka qenë ekzistuese nëpër lumë, të kalohet me traktor. Atë a nuk ke dalë me pa, apo s'ke informacion? Bashkë shkojmë sot, e kryejsh punën, shkojmë baskë me ju, se je qytetar i të gjithëve, jam asambleist për të gjithë, dalim i shikojmë dhe e gjejmë një zgjidhje. Nuk kemi kohë edhe hapësirë për akuza dhe për replika. Çka do t'i servojme, çka do t'i afrojmë qytetarit për këtë moment. Krejt në fund përmende edhe urën e Zaplluxhes. Ajo nuk është funksionale bre rruga, një herë të kam thënë e ke bo si kërcimore, mos më shti me e përsërit edhe një herë, se po merr jehonë. Rregulloje një herë e përgjithmonë, u krye ai problemi, jo po na lë Ministria, jo është e Ministrisë, jo është e Qeverisë, jo është e jona, jo s'është e jona. Është për tmerr. Krejt në fund thaje se ne asambleistët që u duhke me diskutue në fund problemet të cilat i cekem, shkak i nënshkrimit për me kalue në Qeveri, në Ministri pika e KAB-it. Po jepja veç një sy ekzekutivit tënd, falë qatij Qamilit që e kie, edhe po kam qef që po ia përmendi emrin se shoq e kam. Ku e ke një drejtor këtu, a e ke një staf a një drejtor këtu, veç shikoje! Shikoje asambleistët tu ku i ke. Unë me një seancë tjetër, para dy a tri seancave kam kërkuë nga kryesuesja që listat t'i nënshkruajmë në fund kur ta mbarojmë seancën, jo në fillim. Asambleistët tu vijnë vetëm më nënshkrue ditët që kanë qenë këtu edhe me i marrë nga 500 euro. Unë nuk po i detyroj me dalë me folë, se unë i njoh i njosh shumicën e këtyre asambleistëve, po më vjen keq, i kam pas nxënësa, nuk janë kaq të heshtur këta, këta janë shumë të dijshëm, po i ke cunqie o kryetar. Unë po them qeshtu, si në kohën e komunizmit edhe t'gjithë. Unë nuk besoj se këta asambleista janë të padijshëm, e kuptoj se këta janë shembullorë. Jepju lirinë e të shprehurit dhe të mendimit. Jefe një shikim, z.koleg, shiko ku i ke drejtorët, nga 6 drejtori a 7 sa i ke,

vetëm po kënaqem kur po e përmendi shokun tim Qamil Kollonin, e lashtë Zoti me ymër e ishalla gjithmonë rri kështu. Faleminderit!

Shpetim Hajredini: Këtu është bërë problem edhe me e marrë fjalën, se ta nalin fjalën menjëherë. Po mirë është që s'jam pjesë e kësaj anës së majtë, po i bjer tash, jam në këtë pjesën e anës së djathtë. I nderuar kryetar, më preke vetë, s'pata mendjen, po i raje gabim. E përmende atë urën edhe diçka, s'di çka thaje, njëfarë fjalë çibriti. S'e di sa ke njohuri ti në këtë drejtim, po ajo pozita aty që është a mujsh me bo diçka ndryshe, pyeti ata inxhinierat e tu, i ke të njëjtit që e kanë planifikue, e kanë projektue ata. Se unë kam qenë mbikëqyrës, unë e di, për atë urë që e fole ti më herët, për qat urë. Qajo urë ka qenë para tri vjete, unë e di, unë kam qenë aty, ata e kanë projektue edhe kanë thënë mundësi tjetër s'ke këtu. Këta inxhinierat që i ke ti sot, të njëjtit janë. Kryetar, nuk projektosh ti, se ti je doktor, të kam thënë për doktor jë njësh, po as unë e as ti nuk jemi inxhiniera, nuk marrim vesh asnjëri në këtë drejtim, unë ekonomist, ti je doktor. Janë qata inxhiniera që ma kanë projektue mu urën në Kuk, qata janë sot që i ke ti qaty. Të njëjtit janë. Askush nuk iu ka ndërhy atyre me ndryshue urën edhe me projektue si duhet. Në bazë të pozitës dhe vendit ata e kanë pa që nuk ka mundësi dhe opsion tjetër, këtu nuk bëhet, anulaje krejt këtë urën, hiqe krejt edhe atëherë okej. E dinë të gjithë qytetarët, bashkëfshatarët e mi, se gjithmonë vërshimet kanë ndodhë aty, problematika kryesore është mu ajo pjesë. Por ti edhe nëse don me e bo atë urë edhe 10 metre, nëse e ka shkruie i madhi Allah me kalue, ajo ka me të kalue si në Bresanë që është s'di sa metër, 6-7 metre edhe aty të ka kalue përmi, se s'un e ndalë asgjë atë. Nuk bën me bo këso akuza të ulëta. Nuk është që mu po më prekish, beso se nuk ma ndin, e dinë qytetarët sa kam punue edhe çka kam punue për katër vite edhe e dinë çka punohet tash. Gjithçka çka e kam bo, e kam bo për riza të Zotit edhe nuk jam ndalë kurrë. As tash nuk di isha ndalë, po e keni ju mundësinë, ju jeni ekzekutiv, ju vazhdoni punoni. Punoni për të mirën e qytetarëve, nuk ka rëndësi ne çka kemi punuar. Kemi punue mirë a keq, qytetari e di, na ka vlerësue, na ka votue pastaj. Unë e kam edhe një mandat, e përfundoj së bashku me ju, pastaj nëse na mundësojnë, a kemi jetë me kandidue prapë, prapë ata vendosin. Kjo është ajo, në bazë të asaj që më akuzove për urën, pasi kam qenë pjesë e mbikëqyrjes. Tjetra, e dhaje ti një përgjigje për komisionin, thaje prej pesë anëtarëve, ne të kërkuam që në bazë të ligjit edhe Asambleja të jetë pjesëmarrëse. Nuk dhaje përgjigje nëse na lejon ligji apo jo që të jemi pjesëmarrës, apo ne vetë duhet ta formojmë këtë komision edhe të vazhdojmë edhe ne me vlerësimin tonë dhe ta shohim pastaj në fund, ta bëjmë një bashkim edhe të shohim paralelja ku po na qet, se cili më mirë po e vlerësojmë. Edhe një herë po më vjen keq, kryetar, të bëra replikë, më preke edhe nuk është e arsyeshme, në këso raste sidomos të cilat janë të ndjeshme, nuk duhet të kapesh për fije të perit. Megjithatë, më jep përgjigje vetëm për komisionin, për tjerat nuk ka rëndësi. Mos të harrojmë, edhe për buxhetin, natyrisht që ti e dhaje njëfarë përgjigje, që ke kërkuie prej Ministrisë, prej njerëzve kompetentë të cilët merren me emergjenca të cilat ndodhin nëpër qytete të ndryshme të Kosovës. Por,

ne si Komunë, tash ishalla nuk gaboj, më përmirësojsh, thajë që nuk kemi mundësi financiare për me i mbulue të gjitha. Atë e dimë ne të gjithë, por ligji nuk besoj që e ndalon, ato mundësitë financiare që i kemi, t'i kompenzojmë qytetarët. Një shembull konkret e ke, mos gabofsha, para tri viteve – ta Samidin, mujsh pak me më korrigjue nëse jam gabim – kur ndodhi në Zaplluxhe edhe në Blaç, ne përmes buxhetit komunal sa kemi arrit, aq sa kemi pas mundësi i kemi kompenzue këta qytetarë. Edhe tash besoj se e keni këtë mundësi. Ju faleminderit!

Samidin Xheladini: Të nderuar të pranishëm, ju përsëndes të gjithëve! Ne si organ më i lartë i Komunës, e kemi për obligim ligjor, por edhe patriotik dhe qytetar, që të jemi prezentë në seancë. Edhe qeveria, edhe kryetari edhe të gjithë. Unë pak si më me përvojë, më i vjetër, ne e dimë që edhe në mandatet e kaluara, se jemi të zgjedhur të popullit, edhe jemi njerëz në fund të fundit, kemi edhe nevoja. Unë mundohem, asnjëherë nuk dal prej seancës, por nuk ua imponoj të tjerëve që duhet të veprojnë njëjtë. Ne si parti, delegatët i kemi këtu të gjithë prezent. Ata tjerët s'janë, çka me bo tash. Por po e them – parafolësi që tha – ne këtu nuk jemi për parti. Për çështje madhore, sidomos për buxhet dhe për çështje që janë në interes, ne jemi krejt të njëjtë. Unë po ju them, kur kanë qenë vërshimet, kur ka qenë Shaban Shabani edhe është marrë iniciativa, jo veç unë që e kam përkrah personalisht, por edhe subjekti edhe të gjithë unanimisht e kemi votuar. Pse e kemi votue unanimisht? Atëherë ka qenë pandemia, edhe mjetet po të mos i kishim shfryzëue, se ka qenë momenti që kanë mund me na shkue mjetet në suficit, edhe e kemi gjet një modul shumë të përshtatshëm që ato mjetet me i dedikue. Tash projektet i kemi, pse mos me i përfitue mjetet prej Qeverisë. Siç e dini, Skenderajit, si Komunë e varfër, vitin e kaluar i kemi ndihmuar me sasi simbolike, nuk kemi pas më shumë. Presim edhe ne nga komunat tjera. Si Asamble, jemi duke bërë punë të mirë në këtë drejtim. Ne do ta mbështesim çdo iniciativë që është në të mirë të qytetarëve. Por, deshta të them kështu, se ndonjëherë po dalim prej vetes edhe ka pas rast kur kanë thënë se mirë jau u kanë bo. Kemi dëgjue fjalë, mirë jau kanë bo atyre që kanë zaptue. Ajo tingëllon keq, se për shembull, kur të ndije ai që është i dëmtuar, thotë mirë ia kanë bo se e ka zaptue ai lumin. Nuk është mirë, këto gjëra nuk duhet me ndodhë. Edhe e dyta, po ia bëj si në formë hajgare, kish qenë një grue edhe një burrë, ajo grua kish qenë mbret. I kish thënë burrit, sa herë po bjer shi, po e akuzon burrin. Ai shkon e ankohet te hoxha, thotë hoxhë kur të bjer shi kush është fajtor. Po Zoti bre qet shi, i thotë. E gruaja ime po më fajëson mu. E mos të bona ne me i fajësue tjerit për shi që po bjer. Faleminderit!

Jetmir Ajdini: Unë prapë kisha propozue që si ekzekutiv komunal të ndani një shumë të caktuar të mjeteve, që t'ju dilni në ndihmë atyre qytetarëve të cilët kanë problem me furnizim me ujë të pijes, kanë problem në kyçje në kanalizim edhe kanë problem qasje në rrugë, që të sanohen këto dëme që janë elementare dhe fillestare, me atë shumë të mjeteve të mbulohen këto shpenzime. Edhe një herë, si ekzekutiv komunal, do të ju përkrahim çfarëdo shume që do të ndani. Besoj që të gjithë asambleistët

do të përkrahnin një nismë të tillë. Mendoj se është urgjente që, çdo qytetar që është prek të ketë qasje në ujë të pijes, të ketë qasje në kanalizim dhe të ketë qasje në rrugë. Gjëra elementare për një familje. Pastaj, Komisioni do ta bëjë punën e vet, do të vlerësojë dëmet dhe besoj se edhe Qeveria do t'i kompenzojë me aq sa ka mundësi ato dëme të shkaktuara. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Pasi që pas diskutimit tim pat edhe pyetje shtesë, ose kam harrue me ju përgjigj për pyetjet e bëra më herët. Sa i përket asaj se nuk i kemi pas votat edhe për atë keni propozue që ne si pozitë të votohet sefte KAB-i dhe pastaj që të shkohet në Xhuma, është me rëndësi që çdo punë që e nisish duhet të kesh sukses. Me përfundue, e jo me dështue. Unë nuk kam ardhë këtu si kryetar me dështue, por kam ardhë me punue edhe mos me dështue. E, ju që po lypni me dështue, është punë e juaja. Ju që po lypni me dështue, ju jeni të dështuar vetë. Edhe ju vetë thatë që mju më ka hup memoria, nuk kam memorie edhe nuk mbaj mend. Thatë që pse nuk e keni shpallë gjendje të jashtëzakonshme Gjendja e jashtëzakonshme shpallet në bazë të ligjit dhe unë nuk kam dashtë ta shpall gjendjen e jashtëzakonshme dhe pastaj të bëhem qesharak në opinion. Unë jam konsultue, i kam pyet personat kompetentë. Gjendja e jashtëzakonshme shpallet në bazë të ligjit, qat ligj që e lexova, Komisioni formohet në bazë të Rregullores që e lexova. Gjendja e jashtëzakonshme shpallet nëse rreziku vazhdon, nëse vërshimet kanë pas me vazhdue me ditë të tëra, atëherë mund të shpallet gjendje e jashtëzakonshme. Mirëpo, pasi që rreziku për keqësim të situatës ka mbarue, kanë mbet vetëm pasojat, me ligj nuk ke të drejtë me shpallë gjendje të jashtëzakonshme. U tha me lyp makineri prej KFOR-it, unë thashë takimin e kam pas KFOR-in Italian, për makineri, jo për ndihma financiare. Sa i përket projektit në Blaç, ky projekt është bërë vitin e parë kur kam ardhë unë në qeveri. Ne e kemi implementue projektin që e kemi gjet, vetëm jemi kujdes me e implementue në bazë të asaj që ka qenë. Ne kemi dashtë me e vazhdue atë, me e përfundue, por ka pas probleme pronësore edhe njerëzit nuk kanë lënë. Unë nuk po them që atë duk do ta bëjmë, por duhet me bisedue me njeriun, me e bind që mos të kem probleme. Unë do të bisedoj me atë person i cili na ka pengue neve dhe besoj që ajo është puna e vogël, pak mjete duhen. Ka qenë e kontraktume që të përfundojë, por ra bora, s'pat kohë më me përfundue në tërësi urën e Qollopekut. Mjetet nuk kanë shkue në suficit, po i kemi orientue në pagesën e kontratës kolektive. Ura e Qollopekut, është lidhë kontrata me u përfundue, ka pas me ia nis ditën e vërshimeve, NIKI GD e ka marrë. Mirëpo ndodhën vërshimet edhe e kemi angazhue në drejtime tjera, kështu që ajo do të fillojë dhe do të përfundojë. Ura e Zaplluxhes, ju e dini, unë kam qenë iniciator për fillimin e punimeve të asaj ure. Pse s'u bë ajo urë deri më tash, sepse ka pas probleme me pronën. Unë e falënderoj babën e Xhyllferies i cili ka lejue që në pronën e tij të ndërtohet kjo urë. Unë pasi e kam marrë konfirmimin, kam kërkue nga Ministria e Infrastrukturës që të fillojnë punimet e asaj ure. Kanë fillue, mirëpo, nga momenti që janë ndërprerë punimet, unë tri takime i kam pas me zv/ministrin. Para tri dite i kam dërguar email, i kam shkruar edhe në telefon përmes Ëhatsappit, kush nuk beson muj me e çel.

Me mbikëqyrësin e punimeve ndoshta nja 100 herë kam folë. Ka probleme ajo urë, jo me pronën, ka probleme tjera që ata nuk po i tregojnë pse. Mjetet nuk janë të Komunës. Nëse ata na lejojnë neve me e përfundue, ne e përfundojmë. Nuk kemi të drejtë me u përzie, se ajo është rrugë regjionale. Sa i përket asaj se ku janë drejtorët edhe asambleistët, unë asambleistët nuk i kontrolloj. Kuvendi është organi më i lartë i Komunës, i cili përbëhet prej 27 asambleistëve, e ka kryesuesin, zv/kryesuesin, dhe Kuvendi ka të drejtë me e kontrollue edhe punën time. Ju e dini që Komuna përbëhet prej dy shtyllave, kryetari dhe Asambleja. Por është një pikë ku bashkohen kryetari dhe kryesuesja e Kuvendit, ku ata merren vesh për rendin e ditës. Ligji këtu na lejon, ne duhet patjetër me bashkëpunue, edhe kryetari ia propozon kryesueses rendin e ditës, kryesuesja ka të drejtë me pranue ose mos me e pranue rendin e ditës, me shti edhe pika tjera, sepse ajo nënshkruan e jo unë. Unë ju përgjigjem juve edhe, me ligj, unë si kryetar duhet të jem prezent në Asamble. Unë, prej se jam bo kryetar, veç në Qabe kur kam qenë ndoshta nuk kam qenë një herë, tjera herë çdo herë kam qenë. Kështu që, edhe në Grantin e Performancës ne që e fitojmë, gjithmonë te pjesëmarrja e kryetarit në punimet e Asamblesë i kemi 100 pikë. Drejtorët janë këshilltarët e mi, kur është kryetari i zëvendëson të gjithë drejtorët. Jo që unë i di krejt punët, por unë muj me i zëvendësue ata. Sa i përket urës te Kuki, te pjesa lindore në hyrje kah pjesa e lartë e Kukit, ti po thuesh janë të njëjtit inxhiniera. Kjo krejt varet çfarë urdhëra iu japësh, ata janë të njëjtit. Nëse thotë kryetari i Komunës, bonë një urë të përmasave të vogla, ai e bon, sepse i thotë qekaq buxhet kemi. Ju e dini që shkaktari kryesor i vërshimeve në Kuk, jo i vetmi, është bllokimi i asaj ure atje. Ju thatë që edhe te ura e Bresanës ka dalë uji përmi urë. Nuk duhet me krahasue lumin e Bresanës me lumin e Kukit, si i Bresanës është me përmasa shumë më të mëdha sesa lumi i Kukit. Sa i përket Komisionit, unë thashë edhe një herë, nuk kam kqyr që Komisioni të ketë përbërje politike. Nëse e shikoni përbërjen e Komisionit, nuk ka përbërje politike. Komisionin unë e kam bërë në bazë të ligjit, në bazë të këshillave që m'i kanë dhënë dhe ai Komision është definitiv, i ka kompetencat ligjore me e bo vlerësimin e me pru te ju. Ju a bëni komision a jo, ajo është çështje e juaja, unë nuk ju përziem. Po ai komision nuk ka të drejtë me dalë në vend të ngjarjes edhe me bo vlerësim, sepse është i formuar në baza joligjore. Ju mundeni me bo komision me e kontrollue atë Komisionin e kryetarit, po përndryshe raport ai komision nuk mundet me pru, se raportin ai ia bjer kryetarit, e kryetari pastaj e bjer në Asamble edhe Asambleja e voton. Nëse e voton Asambleja, e çojmë në Komisionin qendror, nëse nuk e voton, ngelet ai raport këtu. Edhe unë për fund e kam edhe një apel: Shfrytëzoj rastin që edhe një herë t'u bëj thirrje të gjithë qytetarëve dhe bizneseve private të cilat kanë pajisje teknike dhe mjete motorike, të angazhohen për sanimin e dëmeve në terren. Apeloj te qytetarët e fshatrave të prekur, sidomos banorët e fshatit Kuk dhe atyre vendbanimeve që kanë pësuar dëme nga vërshimet, në rrjetin e ujësjellësit, kanalizimit, të mos e përdorin ujin për pije, por të përdorin ujë të blerë, ose nëse vendosin me e përdorë, ta bëjnë vlimin e tij. Unë para se me ardhë këtu në Asamble, tash në pjesën e dytë, pata një bisedë telefonike me

drejtorin Fadil Kryeziu, i cili i ka marrë mostrat dhe i ka bërë analizat e para, dhe ka apelue që qytetarët e fshatrave Kuk, Kosovë dhe Bresanë, të mos e shfrytëzojnë ujin për pije, ose ta ziejnë. Ndërsa të hënën do të na i bien analizat detale. Gjithashtu, u bëj apel personave që kanë pësuar dëme të të gjitha kategorive, para se ta fillojnë sanimin e gjendjes, të bëjnë fotografi dhe video – ata të cilët kanë mundësi që fotografitë t’i bëjnë me ngjyra është mirë – Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve ka me i marrë parasysh këto dëshmi dhe do t’i fut në dosjen e tyre, para se me e pru vendimin për vlerësim. Gjithashtu, i njoftoj qytetarët e Komunës sonë që atyre që u ka hyrë uji në bodrume dhe deri më tash nuk kanë mundësi me e nxjerrë, të njoftojnë Shërbimin e Zjarrfikësve në numrin 049 773 777, i cili menjëherë do ta angazhojë ekipin dhe do të shkojë në vend të ngjarjes. Ne kemi pas dje dy raste në Bresanë, ku në njërin shtëpi sasia e ujit ka qenë rrafsh me derën, dhe kemi intervenue, është bërë zbrazja e ujit. Qytetarët të cilët kanë probleme me qasje në rrugë, ne jemi duke punuar në atë drejtim, kemi dytri kompani që janë duke punuar. Sa i përket kyçjes në ujësjellës, gjithë qytetarët të cilët kanë qenë të shkyçur janë kyç në ujësjellës. Ujësjellësi funksionon, mbrëmë në Bresanë është rregulluar në ora 23:00 të natës. Nëse ka dikush në Kosovë, ose ndonjë lagje. Sa i përket kanalizimit, nuk ka mundësi pa tender me u zgjidhë ky problem, sepse kanalizimet e dy lagjeve në Bresanë, në Kosovë edhe në Kuk, kanë hy kubëzat nëpër gypa, andaj po duhet kanalizim të ri. Sa i përket ndarjes së mjeteve për ndihmë, ju mund ta bini vendimin, po duhet me i gjet, me i kqyr ku janë ato mjete, se është lehtë me e pru vendimin. Ju e dini që qe tri vite nuk ka rishikim të buxhetit. Nëse s’ka rishikim të buxhetit, nuk ke të drejtë ti si Asamble Komunale me pru vendim, me marrë një projekt, me ia marrë paret një projekti e me i qit këtu, sepse duhet me t’i miratue Qeveria. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdlar: Nuk është e drejtë të thuash që nuk duam që KAB të ketë sukses, je qesharak që nuk i përgjigjesh pyetjes së delegatit. Ne kemi përgatitur pyetje shtesë për këtë pikë. Zonja Kryesuese, kur keni qenë në terren, mund të na dërgoni edhe një mesazh, keni të drejtë ligjore të organizoni një seancë urgjente të kuvendit. Presidenti tha se nuk ka shpallur gjendjen e jashtëzakonshme sepse vlerëson se rreziku nuk ka vazhduar. Si e dinit këtë? Falë Zotit nuk patëm viktima apo të lënduar. Nga informacionet që kam, ka amvisëri të cilat janë përmbytur edhe në Gorë. Goranët e mi janë në diasporë dhe shtëpitë e tyre janë të mbyllura, kur të vijnë do të shohin se sa dëm u është bërë. Si do ta zgjidhni? Përveç përmbytjeve, ka pasur edhe breshket, janë shkatërruar të korrat, kopshtet gjithashtu. Si mendoni se mund ta zgjidhni atë? Insistoi që ne në kuvend të formojmë një komision për ta zgjidhur problemin më shpejt.

Driton Ademi: Kryetar, e bëre një kërkesë te bizneset të cilat kanë ekskavatorë për me dalë me ndihmue. Unë e kisha pa të arsyeshme – ti mundesh me lidhë kontrata deri 999 euro, bare këto biznese me i mbështet, me ua pague naftën ose diçka me i subvencionue. Shumë problem është për me dalë, edhe me i lënë punët tjera që i kanë, edhe me dalë për me të mbështet. Nuk është puna vetëm mbrojtja

e bizneseve, është puna që me dalë edhe këta me e shfrytëzue një të drejtë të tyre. Nëse ka mundësi, këto biznese është mirë me i subvencionue, ose përndryshe, nëse veç i keni të juajit disa të cilët i mbështetni, ajo është krejt tjetër çështje. Edhe pjesa e dytë që deshta me e diskutue... po e ka marrë një tender ose diçka, e shkon e punon nuk e vazhdon punën. Ka kompani, po a i subvencionojsh. Unë e kam thirrë nënkryetarin në telefon, kryetari më tha nuk po mundi unë me i thonë, me thirrë në telefon atë kompaninë, se po duhet me e pague vetë. Qeshtu me ka thënë nënkryetari yt. Nuk po mundi me thirrë kompaninë në telefon, se po duhet me e pague vetë, domethënë prej xhepit të vet, jo prej Komunës. Ka pjesë të vogla, jo shumë të mëdhaja për me i bo. Ka kompani të cilat kanë dalë këto ditë, edhe është mirë edhe me dalë edhe këto ditë, me u sanue këto dëmet deri në fund. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Ne njoftimin si Kuvend Komunal e kemi bërë edhe në gjuhën e komunitetit joshumicë, dhe kemi kërkuar nga të gjithë qytetarët të cilët kanë pësuar dëme, të vijnë të lajmërohen në Komunë. Sot kemi pas dy kërkesa nga komuniteti gorano-boshnjak dhe ne e kemi çuar në vend të ngjarjes Komisionin sot, unë e kam çue, ka shkue me i vlerësue dëmet. Dëmet sa i përket breshërit, e ke fjalën për dëmet në bujqësi dhe blegtori, të gjitha ata e kanë bërë dokumentacionin, i kanë përgatit fotografitë, videot, edhe Komisioni e bën vlerësimin edhe dëmet sigurisht do t'u paguhen ato, Qeveria ka me i pague, se është me ligj. Nëse ne nuk dimë me i mbush letrat, atëherë është gabimi te na, përndryshe kryetari i Komisionit na ka garantue dje që të gjithëve që janë bërë dëmet do t'u paguhen nëse e bëni dokumentacionin në rregull, nëse nuk bëni dallavere, nëse nuk i stërmadhoni dëmet, nëse shkoni me njoftësi a me gjëra tjera. Edhe, kanë thënë bazohuni në çmimet aktuale që i ka ASK-ja, kur t'i përgatitni dëmet që janë bërë. Se ti nuk mundesh me e shkruë që një frizhider kushton 2 mijë euro, kur ai kushton 200-300 euro. Edhe ai normal që nuk na paguan edhe ia humbish edhe atë 200 eurshin, s'un e merr. Është zyrtari ligjor këtu, kryesuesja le të konsultohet vetë, komision të kontrollit mundeni me bo, me e kontrollue kryatrin, me i kontrollue punimet që po bëhen, por komision për vlerësimin e dëmeve me ligj ka të drejtë vetëm kryetari, duke u bazuar në ligj. Por është punë e juaja, unë e di qindpërqind që ju kthehet jo i ligjshëm. Sa i përket asaj që keni thënë me e shpallë gjendje të jashtëzakonshme, unë më shumë se ju kam pas dëshirë me e shpallë gjendje të jashtëzakonshme, por konsultimet që i kam bërë, me kanë thënë gaboish nëse e shpallish se nuk të njihet. Gjendja e jashtëzakonshme dihet kur shpallet. Falë Zotit, shyqyr që ka pushue rreziku i vazhdimit të pasojave dhe vërshimeve, është më mirë që ka pushue dhe ne do të merremi me pasojat. Unë deri më tash e kam përdor autoritetin tim, edhe nënkryetari edhe drejtorët i kanë thirrë bizneset të gjitha në përgjithësi, unë i përmenda bizneset që janë në Komunën tonë, të gjitha. Asnjë nuk e kam lënë pa e përmend, të gjitha kanë dalë, dikush një ditë e dikush dy, dikush tri ditë, edhe të gjitha janë duke e bërë në baza vullnetare. Unë nuk i kam detyrue ata me dalë, vetëm u kam bërë apel, edhe ka njerëz që dojnë me bo mirë, do me punue, do me bo sevap. Ka dikush edhe e ka ndonjë anëtar të familjes aty, shkon me i ndihmue, miqësi

etj., por këto janë të gjitha në të mirë tonën dhe tuajën, edhe mirë është që kemi këso kompani të cilat punojnë. Unë, sa i përket kësaj pike e kisha lut kryesuesen që ta përfundojë, kalojmë në pikën e ndryshme. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë kalojmë te pika e tretë, eventuale. A do dikush tjetër me e marrë fjalën?

Artan Loshaj: Znj.kryesuese, pasi që për pikën e parë të rendit të ditës nuk kemi marrë përgjigje nga kryetari dhe ekzekutivi, së pari të marrim informata, të marrim përgjigje, pastaj ta fillojmë eventualen, se kemi shumë pyetje.

Qamil Kolloni: Unë mendoj se çdo pyetje dhe çdo kritikë e juaja ka arsye edhe vend. KAB-i nuk ka përfundue dhe nuk përfundon deri në shtator. Realisht të gjitha pyetjet që ishin, një pjesë e tyre janë shumë me vend edhe mund t'i diskutojmë, në qoftë se jemi për me diskutue. Në qoftë se jemi për me i politizue, ne mund t'i politizojmë. Unë mendova që, përpos në aspektin profesional për shifra me iu dhënë përgjigje, do t'ju jap përgjigje, në qoftë se më shtini më dhënë edhe pyetje inxhinierike që keni bo, unë nuk do të merrem me pyetje inxhinierike. Mirëpo, unë mendova që ka vend për diskutim, për vetë faktin se KAB-i në filozofinë e vet strategjike ka për qëllim që ta edukojë qeverinë, edhe Kuvendin Komunal, edhe qytetarët, që bashkë të paraqesin një material për shpërndarjen e buxhetit për vitin 2025, që të jetë gjithëpërfshirës. Në mesin e shumë pyetjeve ishte edhe pyetja juaja që ky KAB të jetë sa më gjithëpërfshirës. Prandaj unë mendoj, në qoftë se e shihni të arsyeshme që t'ju jap disa përgjigje për vlerat, për pyetjet të cilat i keni bo, mund të ju jap, në qoftë se mendoni se s'ka nevojë, për mu është shumë më lehtë.

Arijeta Skeraj: Faleminderit, drejtor! Të kisha lut, po më vjen keq që ta dhashë fjalën, pasi asambleistët nuk po duan përgjigje nga ti, po duan nga kryetari, kryetari i Komunës nuk është në gjendje me dhënë sot përgjigje, të kisha lut edhe të kërkoj shumë falje që të fillojmë me pikën eventuale për pyetje dhe përgjigje. Të kisha lut edhe faleminderit! Të kërkoj falje në prezencë të tyre, se unë mendova që do të pranojnë asambleistët, po masi nuk po pranojnë, të isha lut që me e ndërprerë këtë! Faleminderit shumë!

Qamil Kolloni: Shumë në rregull, po megjithatë, në qoftë se doni me ju dhënë disa sqarime profesionale të cilat vetë i kanë ngrit këto çështje, munda me ju dhënë. Po kështu po i bjer se po e politizojnë edhe KAB-in që është detyrë e secilit delegat ta shprehë qëndrimin e vet dhe të marrë përgjigjen të cilën kanë nevojë ta marrin edhe qytetarët. Qeky KAB iu referohet qytetarëve dhe në qoftë se flitet këtu 24 orë për qytetarët dhe nuk u lejohet qytetarëve të marrin informacione reale, atëherë bien në kundërshtim me vetveten. Për mu është shumë më lehtë – po unë e di që për ty s'ka gajle, po nuk do të thotë se je fundi i botës ti.

Arijeta Skeraj: Drejtor, të isha lut edhe të kërkoj shumë falje! Ti detyrën tënde e bëre dhe ke dhënë një pasqyrë shumë të mirë të Kornizës Afatmesme për 2025-2027. Pasi asambleistët kërkojnë nga

kryetari dhe kryetari nuk është në gjendje me dhënë përgjigje, atëherë kalojmë te pika eventuale. Kush don me e marrë fjalën te pika eventuale? Atëherë, në qoftë se ke, urdhëro kryetar! Veç pak për sqarim. Në qoftë se kryetari pak më herët tha se unë do të dal me përgjigje për KAB-in, atëherë u dashtë kryetari me marrë fjalën, e jo me dalë ti. Edhe kur e pashë që asambleistat kërkuan, se unë jam kryesuese e Kuvendit dhe i mbroj të drejtat e tyre – në qoftë se ata nuk deshtën përgjigje nga ti, atëherë e lutën kryetarin, pasi kryetari tash ka shpreh vullnetin që t’u përgjigjet, atëherë të kërkoj falje, shumë të kërkoj falje drejtor, por fjalën ia jap kryetarit të Komunës.

Bexhet Xheladini: Këtu ndodhi një keqkuptim. Unë i thashë drejtorit me dalë në emër timin me fol. Kështu që, pse po thojnë dy asambleistë ose tre mos me folë drejtori, nuk është e thënë që ka thënë krejt Asambleja. Fundit i fundit, qitne në votim, kush është që drejtori t’ju përgjigjet dhe votoni. Atëherë, nëse votojnë shumica që mos të përgjigjet drejtori, atëherë normal përgjigjet kryetari. Po unë i thashë drejtorit del ti në emër tem, se unë nuk thashë do të dal unë t’ju përgjigjem, unë thashë i kam urdhëru drejtorët që të mos dalin me dhënë përgjigje për KAB-in për shkak të kërkesave të asambleistëve që të merret pauzë. I dhashë dy arsye dhe nuk thashë që unë do të dal, po masi ta kryej Qamili, dal edhe unë, nuk është problem, po tash unë qysh e pashë, nuk kërkuan të gjithë asambleistët mos me fol Qamili. Është detyrë e opozitës kjo, dojnë me bo përçamje, po nuk mundin me bo përçamje. Unë s’jam i interesuar me e përça opozitën. Dëgjo, kryetari kur ta autorizoj drejtorin me dalë e me folë, kryesuesja nuk më ka pa mu që i kam thënë unë Qamilin del, se po të më kishte parë nuk ia kishte ndërprerë fjalën drejtorit. Unë kam pas me dalë për stadionin me folë, e di që ty stadioni të djeg ma shumë, se qaty e keni dhimtën më të madhe. Ai është projekti që shumë e due, mas ujësjellësit është projekti që më së shumti e due, edhe pse s’jam vetë futbollist.

Arijeta Skeraj: Te lutem, Artan Loshaj, mos provoko me sy, të lutem edhe një herë po ta tërheki vërejtjen! Në qoftë se ke dëshirë me dëgjue kryetarin, nëse jo, me këso manipulime nuk lejoj në sallë ti me bo mu me gjeste që nuk më lejohet. Të isha lut edhe një herë, në qoftë se dëshirë me dëgjue, dëgjo, nëse s’duesh, të lutem asnjë fjalë tash e mas nuk të lejoj. Lype drejtorit me ia ndalë – që mu marre po më vjen qysh ia kam ndalë drejtorit, kur ai e ka pas detyrë KAB-in. Të isha lut edhe një herë personalisht ty!

Bexhet Xheladini: Atëherë unë po filloj me stadionin. Megjithëse unë të kam dhënë përgjigje në Komitet, po aty s’kanë qenë mjetet e informimit, tash i kemi. Unë të thashë projektin numër dy, mas ujit, e kam stadionin, edhe nëse jam gjallë e shëndoshë qat stadion kemi me e përfundue. Edhe e përdore dje një video, nuk është ajo që unë kam thënë. Unë kam thënë: Më ka thënë ish-kryetari se kur e kanë pyet gazetarët pse s’e keni bo stadionin, ai ka thënë ka probleme me gjykatë. Arsyetim pse s’e ka bo. Tash, a ka problem me gjykatën a s’ka nuk e di, tash unë nuk kam dashtë me e bllokue punën, unë kam vazhdue. Kene ndarë mjete ju, unë kam propozue e ju keni nda, me qato unë i kam nxjerrë edhe afër

300 a 400 mijë tjera, përmes kryetarit të FFK-së. Ne e kemi bërë një memorandum bashkëpunimi me ta, ku me ato pare që i kemi na do ta përgatitim stadionin për vendosjen e tepihut, ndërsa tepihun do ta bjer Federata, edhe kjo fazë është kryer. Ndërsa në pjesën tjetër ku ka me i krye Federata punët që i takojnë, është rrethoja edhe zhveshtorja. Ditën kur kanë ardhë me i pa përfundimin e punimeve, unë kam pas takim me mbikëqyrësin e punimeve nga ana e FFK-së – se ti gjeth po akuzojsh e keni vu të njëjtin person – mbikëqyrësi i punimeve është i Federatës, kurse personi që e kemi ne është personi përgjegjës vetëm për mjetet tona, po ata ia kanë dhënë edhe një të drejtë që me i mbikëqyrë edhe punët e Federatës, sepse ne jemi përfitues, të në bëhen punët në bazë të projekteve. Ne para disa ditëve e kemi bërë njoftimin që do të bëhet përrurimi i fushës, s’kemi thënë i stadionit, duhet me dallue fushën edhe stadionin. Sepse Federata ka kërkue që ta bëjmë këtë përrurim, për arsye se i kanë kërkue nga FIFA që të bëhet përrurimi, në mënyrë që ata me ia lëshue pastaj mjetet tjera për me e bo rrethojën edhe zhveshtoren. Unë të njëjtën ditë e kam pas edhe një bisedë telefonike me kryetarin e Federatës, jemi marrë vesh për disa punë, e kemi caktuar edhe datën, mirpëpo gjendja emergjente shkaku i vërshimeve e kemi shty edhe do ta bëjmë një ditë tjetër. Unë kam qenë e kam parë vetë zhveshtoren edhe nuk më ka pëlqye. Atëherë e kam formue një komision për me shkue me e vlerësue, a me prish apo me renovue. Ai komision ka me dalë në vend të ngjarjes edhe ka me pru një vendim. Nëse e bjer vendimin me u renovue, do të rinovohet. Ne kemi ndarë mjete financiare 185 mijë euro për stadionin, për punë tjera, për tribina etj. Këto mjete janë paratë e komunitetit shqiptar, nuk janë mjete që kanë hy në ndarje të drejtë të buxhetit, mjetet tonat janë, 185 mijë euro në stadion, 40 mijë euro në Gjimnaz dhe 20 mijë euro në qytezën e Dragashit i janë shtue buxhetit. Këto janë mjete të gjitha që nuk kanë hyrë në ndarjen e drejtë të buxhetit. Mirëpo ndërkohë, masi jua kemi çue materialin juve, nga Qeveria e kemi fitua një ptojekt të stadionit, për shëtitorën edhe për ndriçimin. Kështu që ne këto mjete, kur të vjen shtatori do t’i zvogëlojmë, do t’i orientojmë diku tjetër dhe do të lëmë mjete aq sa na duhen. Unë, para se me kalue mandati, ky stadion ka me u lëshue i tëri në funksion, po më vjen keq që KF ”Opoja” që, me sa kam unë njohuri – nuk e di a është e vërtetë a jo – ka ra prej Ligës. Nuk e di a është definitive, po është për keqardhje kjo. Unë si kryetar i Komunës jam angazhuar maksimalisht vitin e kaluar që KF “Opoja” ta fitojë atë lojën e barazhit. Kam qenë edhe vetë prezent aty. Kam bërë të gjitha përpjekjet që të mos i bëhet ndonjë padrejtësi, dhe kam kërkue nga kryetari i Federatës që të vendoset VAR-i patjetër. Edhe VAR- e ka shpëtue KF “Opojën” edhe ka hy në Ligë të Dytë. Unë si kryetar i Komunës, përmes subvencioneve e kam ndihmuar klubin. Nuk janë ato paret e mia, ju keni votuar propozimin tem edhe ne kemi ndarë çdo herë nga 34 mijë deri në 38 mijë euro për çdo vit për KF “Opoja”. Ato nuk kanë qenë të mjaftueshme, por mundësitë tona janë të tilla. Dikush pat kritika për investimet kapitale, që nuk po ju pëlqen, ndoshta dikujt, ndonjë asambleisti nuk i pëlqen, mund t’i quani edhe investime të gabuara. Por, në bazë të një sondazhi që është bërë dhe është publikuar – dikush e ka parë, dikush s’e ka parë –

90% e qytetarëve të Komunës së Dragashit që janë pyet, janë të kënaqur me investimet kapitale që i kemi bërë ne, janë të kënaqur për mbikëqyrjen edhe janë të kënaqur me kualitetin e punimeve. Kështu që, sa i përket investimeve kapitale, unë nuk e di a kam nevojë edhe me u përgjigje në pyetje, sepse verdikti i popullit – 90% kur të thojnë që janë investime të drejta dhe kualitative – atëherë s’kam nevojë me iu përgjigj pyetjeve të tjera. Sa i përket KAB-it, ai nuk është përfundimtar, drejtor Qamili e tha, atë mund ta ndryshoni ju, edhe shumën e mjeteve, edhe emërtimet. Ke problemi të emërtimet e ndriçimit, ne kemi ndarë mjete edhe për ndriçimin që do ta bëjmë në Brrut, edhe në Kuklibeg, kemi ndarë mjete me e bo ndriçimin e tërë fshatit, të gjitha rrugëve edhe rrugicave, sepse kemi ndarë mjete të mjaftueshme. Dhe, Qeveria e pranon edhe këtë formë të emërtimit ku thuhet qendra. Ndërsa, sa i përket emërtimit të projekteve tjera edhe ndërrimit të destinimit, ju mundeni me e bo si Asamble. Unë jam në gjendje me i pranue propozimet e juaja edhe ju me i votue. Nuk është problem fare. Ka mundësi që deri në shtator marrim edhe mjete tjera, sepse ne kemi paraparë edhe shumë mjete për mallra dhe shërbime, qeveria mund t’i qet në investime kapitale, do t’i orientojmë. Do të orientojmë edhe mjete shitesë, përveç ato që i kemi paraparë në KAB, për Brezne, diku edhe 35 mijë euro do t’i qesim për kubëzim. Pas fillimit të kubëzimeve në fshatin Brezne, kemi pas shumë ankesa të qytetarëve, kanë ardhë kërkesa që disa rrugë nuk janë përfshirë, e me këto 35 mijë eurot do t’i përfshijmë të gjitha rrugët dhe në fshatin Brezne nuk do të mbetet më asnjë rrugë e pakubëzuar. Faleminderit!

Nexhat Selaj: Kryetar, kur po të shoh në këtë gjendje, po më vijsh keq se ke mbet si i hutuar, s’po dish kah me shkue. Duhet të jesh transparent, mungesa e ekzekutivit të bjer në këtë situatë. Janë 22 kërkesa të cilat t’i kemi bërë, njëra prej atyre në eventuale që e latë të diskutohet ishte problemi i Gjinnazit. Nuke e ke drejtorin, se nuk je gjithëpërfshirës, kryetar, duhet ta kuptosh atë. Aspekti profesional, sa mundesh ti, unë nuk do të mund të kundërshtoj. Në aspektin profesional ekonomik, unë nuk mund të kundërshtoj që të del ekonomisti dhe të jep sqarime. Në aspektin e fushës së arsimit, e ke drejtorin. Ku e ke drejtorin që ta dalë të ballafaqohet këtu me ato fakte të cilat unë i parashtrova pak më përpara. Nga kush i lyp këto, kush më jep këto përgjigjet. Tash unë e kuptoj se drejtori Qamili po drejtohet. Drejtor, mundesh vetëm për shpenzimet. Unë kam edhe shumë çka me pyet, që dalish keq kur të dalish këtu, s’un t’i boj ato pyetje se të kam shoq. Ti duhet me e pas projektin zhvillimore për trajnimin e kurrikulës, që është me ligj, të të gjitha shkollave. Ku e ke drejtorin ta jepe ku e ka projektin? Se me ligj është ai. A është hartue aty, mjetet buxhetore që duhen kaq mjete të ndahen? Për atë arsye e pres unë drejtorin me dalë këtu. Për atë arsye i jam lut edhe pak më parë Qamilit të mos dalë këtu se do t’i bëjë një revansh që mbet keq, se s’ka përgjigje me më dhënë. Aspektin profesioinal të investimeve krejt okej. Shkolla ka shumë probleme, kryetar. Ato probleme nuk i zgjidhish ti, më falë që po të them! I zgjidh vetëm drejtori i Drejtorisë, i cili është i thirrur për atë, se e lexon atë projekt me asambleistët edhe del e jep sqarime. Mu më vjen keq që ke dalë me këtë pozicion, se nuk po dish kah të mbahesh. Herë këtu dalish

ti, e herë Qamili, kjo tollovi krijohet kur nuk e ke ekzekutivin para vetes. Nuk mund të më ofrojsh përgjigje për arsim, kur unë po të them ku i ke projektin e hartuar për trajnimin e kurrikulës. Çfarë do të më japësh ti këtu? Urdhëro, që bina është për ty, të lutem! Për këtë del, për shpenzimet 40 mijë, është turp për arsimin të ndahen 40 mijë euro për Shkollën e Mesme “Ruzhdi Berisha”. Pak më parë me Qamilin biseduam jashtë Asamblesë, tha janë 40+40. Unë në letër i shoh 40 mijë euro. Lista e Shpenzimeve Kapitale 2025-2027, faqaj e tretë, Arsimi dhe Shkenca, Nr.5, Ndërtimi i nyjeve sanitare dhe hapësirës multifunksionale në Shkollën e Mesme “Ruzhdi Berisha” – 40 mijë euro. A nuk është turp 40 mijë euro investime në ShM “Ruzhdi Berisha”, përderisa një kulm i një shkolle fillore X – s’po e përmendi ku – ose një oborr, të kushtojë 40 ose 50 mijë ose 70 mijë. Me drejtorin bisedova pak më parë, thotë janë plus 40 mijë. Po çka janë 80 mijë euro për Gjimnazin. A me 40 mijë mundohesh Gjimnazin, aneksin – ta përmenda pak më parë, për atë arsye, kur tentojsh me qenë i shumëanshëm, dalish këtu edhe humbish se nuk dish ekzekutivin. Për aneksin – pasi po thuesh do t’i jap të gjitha përgjigjet – ka qenë 2023-2024 të përfundojë. 2024-ta për mendimin tim ka mbarue në momentin kur i kemi lëshue nxënësit nga shkolla. Pse po të them këtë? Kemi edhe gjashtë muaj të tjerë, po a non stop ne do të kemi zhurmë me ato makineritë, që mësimin nuk po mundim me e zhvillue normalisht. Edhe tash, duke pasur parasysh kushtet meteorologjike, në shtator a mund të kemi siguri ne që do të kemi kohë të mjaftueshme të mirë, kur kie vetëm bazën edhe katër shtylla i ke të vendosura. A në 2024-tën ka qenë e obliguar ajo që të hyjmë brenda ne, të kemi pajisje. Këtu s’po shoh unë, as për vitin 2025-2026-2027 nuk ke të planifikuara. Tash urdhëro del, a po mundesh me më dhënë sqarim, jo mu, po me iu dhënë kolegëve, elektoratit, me iu dhënë edhe nxënësve. Me iu dhënë 400 e sa nxënësve, që ata e presin se ky aneks keni premtue që do të ndërtohet dy ose tri objekte të cilat do të furnizojnë për vendosjen e kabineteve. Unë nuk di çka të flas tjetër, edhe nëse do të jem pak më i zhurmshëm, se i përkas asaj shkolle dhe i përkas nivelit të arsimit. Për shkollat do të punoj ndoshta më tepër, po kam pak mëshirë edhe ndaj kolegëve, se kam edhe për kolegët këtu, mësuesa të partisë në pozitë që nuk e çelin asnjëherë gojën. A krejt në rregull është, gjithçka është mirë nëpër shkollat e juaja? Unë nuk flas tash – politikë s’jemi ka bëjmë. Nëse llogarisesh që shkolla është politikë, unë nuk dal kurrë të flas. I kemi fëmijët e të gjitha strukturave politike në ato shkolla. Pikërisht më dhëmb dhëmbi aty ku edhe punoj, në Gjimnaz. Faleminderit!

Artan Loshaj: Para se me e marrë fjalën, kryesuese, nuk po due me u lëshue me ty. M’u duk se më ofendove, unë fjalë nuk të thashë. A sa qysh rri në vend atje, nuk jam këtu parashkollor po jam në Kuvend. Në qoftë se të kam bo naj gjest pa qëllim, unë ty të kërkoj falje, përndryshe due me më kërkuë falje. Edhe po due me të bo një pyetje, a do të jetë diskutimi i fundit për krejt seancën? Okej. Puna e stadionit, kryetar, se u bo hit. Unë të kam thënë dje, po të them edhe sot, ju publikisht keni deklaruar se ka probleme. Kur ka pas probleme – në qoftë se pretendohet se ka pas probleme – pse keni vazhdue

punën? Një, e dyta: Gjendja është tejet e rëndë në zhveshtore, është mjerim, e kam videon. E keni bo fushën e stadiumit, shumë mirë. Po pritni të bëher rrethoja dhe zhveshtorja. Ju po doni me ia bo si '97-tën kur ka ardhë Sali Berisha, është e Enverit edhe prishne. E ka bo PDK-ja, ju po e prishni. Pse po prishni? Dënoni keqbërësit, pa marrë parasysh a është PDK a LDK. Jo s'merrem, keni me u marrë, se e keni pranue qeshtu pushtetin. Është gjendje e jashtëzakonshme aty. 200 mijë euro ka kushtue stadiumi. Tre rojtarë, një bre merne qetash me e rujt atë stadion deri të bëhen punimet. Kjo është e pafalshme! Të kam thënë edhe prapë po të them, të njëjtin mbikëqyrës të cilin – nuk po them që ka keqpërdorime aty, ju vetë keni thënë – të njëjtin mbikëqyrës të cilin e kemi pas ne, të njëjtin e keni ju. Është publike ajo, unë s'po shpifi. Është e pafalshme kjo, kryetar. Mundesh ti çka të duash me thënë, veç me i amnestue ata vetë i ke amnestue, kryetar, në qoftë se ka keqpërdorime. Unë nuk po të them ka keqpërdorime, unë po të them stadioni është në gjendje të rëndë, u krye muhabeti. Masi nuk po më jep fjalën më kryesuesja, dalim në eventuale, në shëndetësi. Disa kolegë parëz këtu e diskutuan, unë po due me ju thënë që në shëndetësi tre-katër muaj nuk ka punue Rëntgeni. Ju e dini pse, jo tenderi e jo ato, ka fillue me punue. Ndërsa Laboratori, një arsyetim që e ka bo drejtori i Drejtoratit – se deshta profit Nexh mos me i mbet borxh – kur u nda hisja për 2025-tën, Drejtorati i Arsimit dhe Shëndetësisë nuk ka qenë prezent aty edhe kanë dalë zero-zero. Unë qashtu po mendoj. Veç 40 mijë për hatër jau kanë dhënë juve, edhe për shëndetësi nuk kanë dhënë kurgjo. Zonja kryesuese, na dhaje krejtve vërejtje, ne jemi kuvendarë, nuk jemi ekzekutiv. Nga ekzekutivi, përveç kryetarit, kujt nuk i dëgjohet – është mirë me dëshue – kujt nuk i dëgjohet, dera është çelë, është në anën e djathtë. Faleminderit! Laboratori qe disa muaj, kryetar, punon me 5 deri 6 analiza, edhe ato janë – se je mjek, doktori këtu s'qenka, Arijeta e di shumë mirë – në Laboratorin e QKMF-së bëhen: Glikemia, Keratinina, Transaminalet ALT- EST, edhe trigliceridet, kolesteroli. Ndërsa, elementet bazë, analizat bazë, se je mjek, je specialist, nuk bëhen sedimentacioni, nuk bëhet urina edhe nuk bëhet një pasqyrë gjaku ose një hemogram. Në QKMF, në çdo qendër Sektori i Urgjencës e ka një Laborator të cilin mund një pasqyrë gjaku ose një hemogram me bo edhe punëtori shëndetësor, mjeku apo infermieri. Pas orës 15:00 – unë nuk jam kundër me shkue pacientët në laborator privat, jo absolut – unë po kërkoj nga ju si kryetar, që analizat elementare, bazë, që janë për një QKMF, të bëhen në QKMF. Pas orës 15:00, edhe të shtunë e të dielën, është mirë të jetë laboratori, një pasqyrë gjaku, një urinë me e bo, edhe të mos shkojnë pacientët me bredhë në Prizren. Këtë e dish shumë mirë, kryetar. Ata mjekë edhe ata kolegë të mi, shumica prej tyre janë shumë të mirë, se sidomos mjekët, mbi 80% të rasteve – je mjek – e dish që trajtohen në kujdesin primar shëndetësor. Një mjek, pa një pasqyrë të gjakut, pa një urinë, është problem me pru diagnozë. Ata janë heronjtë më të mëdhenje të kësaj Komune, ata janë si do ushtarë në Koshare që kanë qenë edhe në Pashtrik, me armë po pa plumba. Ose, një mësues me shkue me ditar në dorë, e mos me pas laps me qit nota. Kryetar, merru bre me qeto. Ju kam thënë disa herë, prapë po ju them, mo nuk e foli. Mësuesi Behar, nuk është

bre për shëndetësi. Mirë ia ke gjet vendin për urbanizëm, lëje bre te kubëzimi, te kockat, te kanalizimi, te këto sende. Nuk kemi drejtor të Shëndetësisë, nuk ka kush me lyp prej teje. Faleminderit!

Afrore Vejseli: Përshëndetje edhe një herë, faleminderit për fjalën! Po ndërroj pak temë. Në një mbledhje më herët të Asamblesë, z.kryetar, pata parashtruar një pyetje – ose propozim ka qenë - rreth caktimit të një date për përkujtimin e eksodit gjatë luftës, si dhe për një nderim të martirëve të Opojës gjatë kësaj kohe. Në pyetjen time kam marrë një përgjigje aty për aty nga kryetari, sipas tij, që unë po u dashka me e paraqit një kërkesë në drejtorinë përkatëse. Z.kryetar, unë jam asambleiste dhe kërkesat e mia i trajtoj në Asamble. Kështu që, janë drejtorët tuaj ata që duhet t'i analizojnë këto kërkesa. Unë pra edhe një herë po kërkoj që DKRS-ja të gjejë mundësi që të bëjë diçka në këtë drejtim. Shqetësimi im tjetër është edhe turizmi malor, tani nuk po du me përmend me emra vendet të cilat më parë janë rregulluar, por po jua bëj një kërkesë që, kryetari së bashku me stafin e tij të bëjë edhe ndonjë selfie në këto vende që janë për të ardhur keq. Edhe në fund, z.kryetar, kam një pyetje për çerdhen që do të hapet këtu në qytezë. Ndonjë informacion më shumë për këtë, që po flitet se do të hapet, në shtator më duket. Ju faleminderit!

Nedžmidin Sejdir: Zonja Kryesuese, së pari, është e pasjellshme që ju të silleni me mua kështu. Unë jam konsultuar me z. Jonuzi si nënkryetar i kuvendit, si një njeri që ka autoritetin kushtetues që kur të më shkëlpi të drejtat bazuar në përkatësinë time etnike te reagoj. E kuptoj që je alergjik ndaj pranisë sime këtu, por çfarë të bëj, më ka zgjedhur populli, prandaj duhet të më durosh dhe të më dëgjosh. Dhe mos më mohoni të drejtat e mia ligjore. Unë kam të drejtë të flas në mbledhje. Do të vij këtu të flas sa të jem gjallë dhe sa që mandati im të zgjasë. Ju kaluat nga një pikë në tjetrën dhe nuk e futët propozimin tim në votim. Propozimin e kam bërë tre herë. Prandaj ju lus zoti Jonuzi të kontaktoni Gjykatën Kushtetuese, sepse mendoj se Kryesuese më ka diskriminuar në bazë të përkatësisë etnike. Unë kam bërë një propozim tre herë nga foltorja dhe ju nuk e keni kaluar në votim. Edhe më herët, kur Samidin krijoi një skandal, ju e mbyllët seancën dhe nuk më lejuat t'i përgjigjem zotit Kolonio, i cili më ofendoi dhe më kërcënoi në formë të përdredhur. Pse vetëm më këshilloni? Ju drejtoni kuvendin dhe jeni përgjegjës për rendin, për të mos më diskriminuar. Koloni nisi disa histori nga kompania ku ne punonim, po të filloja unë në të njëjtën mënyrë, sigurisht që nuk do të ishte drejtor finance. Ai mbron këta tradhtarët tanë, që na tradhtuan neve edhe juve. Seancën e kaluar kanë dhënë para te Gores për t'i shpenzuar në Opoje. Ata janë tradhtarët më të zakonshëm për mua. Ju lutem respektoni të drejtat e mia.

Shpetim Hajredini: Përshëndetje edhe një herë për të gjithë! Edhe pse jemi të lodhur, por natyrisht duhet edhe t'i japim një përfundim atyre replikave të cilat i patëm më herët me kryetarin, edhe drejtori natyrisht pak u inkuadrua në diskutim. Unë s'e di sa më dëgjoj kryetari, po edhe drejtori, besoj që më ka dëgjue mirë, që thashë se ka të drejtë shumë në anën ligjore drejtori që ta marrë fjalën, nëse ia jep atë drejtë kryetari. Por, realisht, pyetjeve të mia unë thashë që nuk ka kurrfarë efekti tash më dha

përgjigje apo jo, pasi që KAB-i ka ec, u votue dhe unë e kam pas propozimin e kam bo. Për këtë edhe thashë nuk ka nevoj, doli e s'doli, më dha mu përgjigje apo jo, nuk ndikon në këtë moment. Përndryshe, ai e ka pas të drejtën ligjore dhe askush nuk mund ta kontestojë. E nderuar kryesuese, ma përmende më herët emrin, nuk pata dëshirë të inkuadrohem në atë që e diskutove, çështjen e prezencës tuaj në fshatin Kuk gjatë vërshimeve, dhe shënimin që ma ke bo mu për takim. Unë jam munduar në momentin që e kam parë – edhe pse unë kam qenë prej fillimit derisa kanë arritur mekanizmi dhe e pashë që nuk ka pas më rrezik, unë kam qenë aty dhe nuk jam largue asnjëherë nga vendi i ngjarjes. Jam mundue fizikisht sa ka mujt me punue, iu kam ndihmue fshatarëve të mi, të cilin e kam obligim edhe qytetar edhe moral. Prandaj, ti mu më ke shënue – me orar të saktë – në 20:30 në mos gabofsha. Unë nja katër a pesë minuta më vonë ta kam kthye përgjigjen, ti nuk e ke pa. Pastaj unë kam dalë prapë, të kam thirrë në telefon – 21 e diçka ka qenë ora – më ke thënë nuk jam në Kuk. Ishte lapsus apo jo, ti e thaje që deri në ora 23:00 ke qenë në fshatin Kuk. Kjo bjer ndesh me atë që e kemi diskutue ne, mëgjithatë nuk due me e qit unë veten poshtë para qytetarëve, se më shënoi njëri që nuk është e drejtë, sikur unë nuk paskam pas dëshirë me ty dhe e kam kthye në çështje politike, nuk kam dalë. A unë realisht kam qenë aty, edhe të kam thirrë që mujm me u takue, se s'më çon mu peshë, ti e dish që kam respekt të madh edhe për ty, edhe për kryetarin dhe ekzekutivin, e sidomos këto raste kur janë të patjetërsueshme takimet. Duhet të bëjmë bashkërisht të pamundurën që ta tejkalojnë këto familje këtë ngjarje. Prandaj, kjo që e thaje nuk qëndron për mu. Tjetra që pata me e diskutue me kryetarin. Edhe në vitin e kaluar e di që nuk e kam votue unë buxhetin, për shkak të fshatit Kuk. Kam thënë se buxheti i cili i është ndarë fshatit Kuk është buxhet shumë i vogël në krahasim me disa fshatra tjerë të cilëve i është ndarë një shumë pak më e madhe. Edhe këtë vit prapë nuk jam i kënaqur. Por i nderuar kryetar, ti e di që një prej shumave më të mëdhaja që janë ndarë për fshatin Kuk, është kubëzimi prapë – 87 mijë e diçka. Dhe pikërisht është njëra prej rrugëve që është prek nga vërshimet. Tash kjo rrugë sigurisht që do të ndërtohet komplet e re, për arsye se është e prishur komplet. Kjo shumë, për atë diskutova më herët që është dashtë të bartet në një projekt tjetër, se kjo do të kryhet ashtu-ashtu, besoj, nëse qeveria lëshon buxhet, do të kryhet këtë vit, dhe për vitin e ardhshëm do të ndryshohet kjo shumë, do të kalojë për projekte tjera. Por ajo nuk ndodhi, se ishte me nguti, dhe nuk ishte përgjegjësi e jona, por as nuk ishim ne ata të cilët e ndaluan përgjigjen tuaj para Xhumasë. Por, ishte koha e kufizuar e juaja që ta dërgoni KAB-n në organet gjegjëse qendrore. Unë atëherë qysh në fillim ju kam thënë, i kam kallxue Grupit tim që sot është data e fundit dhe sot duhet të dërgohet patjetër KAB-i. Prandaj, nuk jemi ne fajtorë pse nuk e morëm përgjigjen e juaj para Xhumasë, apo menjëherë pas Xhumasë, pa u përfundue pika e rendit të ditës. Por, fajtori është tjetërkund, koha e kufizuar që është dashtë të dërgohet ky material në Ministrinë përkatëse. Tjetra, i nderuar kryetar, punimet i përmende, që thaje keni marrë prej një sondazhi 90%, që janë punime perfekte. Ashtu m'u dok që e tha. Kush e ka bo këtë sondazh nuk e di dhe cilët persona e kanë

krye këtë sondazh, prej ku e kanë marrë këtë. Unë qato punime që i kam pa qaty në fshat temin, vallahe nuk janë perfekt, edhe e dish edhe ti mirë vetë. Por, dhashtë Zoti e është ajo qysh ti po e thu këtu dhe qysh e paskan votue ata qytetarë. Teke e fundit, ato paret të cilat i investojmë te qytetarët, ato janë të qytetarëve, nuk janë tonat. Prandaj, ne duhet t'ua kthejmë në mënyrën më të mirë të mundshme qytetarëve. Qoftë ti, apo ai më herët që ka qenë, apo ai kryetar që do të vjen pas teje, të gjithë duhet të punojmë për të mirën e qytetarëve. Prandaj, krejt kjo që po debatohet këtu, gjithmonë në foltore, unë gjithmonë i iki politikës, asnjëherë s'e kam bo politike. A, po jua them sinqerisht, ju gjithmonë e ktheni në politike. Nuk është kjo e drejtë, se tek e fundit e kemi për obligim ndaj Zotit. E ke marrë votën, duhet të punosh për qytetarët, për katër vite e ke obligim. Se kemi me dhënë përgjegjësi edhe llogari para Zotit, ta kam thënë edhe disa herë. Të dy, edhe ti, edhe unë edhe të gjithë këta, deshtëm apo s'deshtëm, llogari Allahu ka me na lyp në atë dynja. Prandaj jemi këti, të punojmë për të mirën e tyre, sa kemi mundësi. Ti e ke timonin, grahi qysh po dish, qysh është më së miri. Na të japim akuza, apo të japim edhe këshilla, nëse dësh me i pranue, i pranojsh, nëse s'don s'i pranon, e drejtë e juaja është. Ju faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Para se me ia dhënë fjalën dikuj, atëherë Shpetimi m'u drejtua mu. Unë para se me mbërri në Kuk, në ora 20 e diçka e kam thirrë Shpetimin. Shpetimi m'u ka lajmëruë në ora 20:41. Unë i kam thënë që kesh me e vizitue Kukin dhe kam fillue në drejtim të Kosovës. Në ora 22:30 kam qenë në Kosovë, Pas orës 22:30 kam vazhdue fshatrat tjera, ku deri në 00:45 kam qenë nëpër të gjithë fshatrat e Komunës që kanë qenë të prekur. Për këtë arsye nuk të kam thënë që në Kuk kam qenë tanë natën, po i kam vizitue të gjitha fshatrat.

Bexhet Xheladini: Kryesuesja sigurisht që mas fjalës time më do ta përfundojë, se nuk pat më asambleistë të cilët duan ta marrin fjalën. Sa i përket Gjimnazit që i përmendet 40 mijë euro. Ju e dini që se kam ardhë në qeveri si kryetar, me miliona euro kemi investue në arsim, s'po them në Gjimnaz. Në buxhetin e vitit 2025 ne prapë kemi parapa mjete në arsim, por për Gjimnaz kemi paraparë vetëm 40 mijë euro. Kemi paraparë 40 mijë euro, sepse kemi pranuar kërkesën nga drejtori, me e përfundue projektin që e kemi nis vitin e kaluar, e që për fat të keq s'u përfundua. Arsyeja është se ka qëllue një punëkryes i keq, e dyta, kushtet meteorologjike nuk lejuan edhe ai projekt nuk ka përfundue. Me këto mjete, ai projekt që është nis ka me përfundue. Kërkesë tjetër nga drejtori i Gjimnazit nuk kemi pas, për ndonjë investim tjetër. Kështu që ne s'mujm me nda mjete për Gjimnaz, nëse nuk ka kërkesa nga menaxheri i shkollës. Mua m'u drejtove me pyetje për këtë 40 mijëshin, pse 40 mijë. Unë të tregova pse. Në shëndetësi këtë vit nuk kemi paraparë për investime kapitale, sepse s'ka nevojë. Ju i përmendet mjetet të cilat i kemi paraparë këtë vit, për vitin 2025 edhe me projeksione 2026-2027. Projeksionet ju i dini, edhe ti Artan e dish çka do me thënë, projeksionet duhet me u bo patjetër. Ato nuk janë investime përnime. Duhet me i bo projeksionet, se edhe ju i keni bo qashtu, edhe normal ligji e lejon. A, të sakta

janë mjetet të cilat janë paraparë për projektet që do të bëhen në vitin 2025. Thatë për stadionin dënioni keqbërësit. Unë nuk jam gjykatës. Edhe thatë po i amnistioni. Unë nuk jam as presidente me i amnistue, unë jam kryetar i Komunës. Rëntgeni është e vërtetë që s'ka punue, kemi pas probleme me tenderin edhe me kompaninë e cila edhe pse e ka fitue projektin, s'ka ardhë me e nënshkrue kontratën. Jo s'un po e gjej pajisjen, jo e kam paraqit ofertën ma lirë sesa po kushton pajisja. Jemi detyrue me e anulue, me e bo tenderin tjetër. E kemi bo prapë tenderin tjetër, pajisja sa kushton, prapë ka konkurrue, e ka fitue tenderin, dy muaj nuk po vjen me e nënshkrue kontratën. Arsyeja dihet pse, ma mirë është me i fitue 50 mijë euro, sesa 5 mijë euro, sa kushton qajo pajisja. Laboratori është e vërtetë, për keqardhje, që nuk i bën të gjitha analizat. E dish pse. Deri në momentin kur nuk u hap ky Laboratori privat, nuk kemi pas shumë probleme. Në momentin që u hap ky Laboratori privat, kemi probleme vërtet, kemi probleme me tenderat, e njëjta është sikur me Rëntgenin. Për arsye se, Qeveria e kaluar, kur i ka ble aparaturat, i ka ble që këto aparatura mujn me u furnizue me material vetëm prej një kompanie, dhe nuk kanë të drejtë kompanitë tjera me konkurrue. Tash e njëjta kompani e ka hap Laboratorin, edhe më mirë është me i fitue 100 mijë, sesa me i fitue 30 mijë. Por megjithatë, ne do ta gjejmë një zgjidhje. Në Sektorine Emergjencës ju duhet me e pas një laborator, është propozim i mirë, do ta shqyrtojmë. Për Beharin që po thuesh drejtor, drejtorat i zgjedh unë. Unë kur kam qenë kryeshef i Ekzekutivit nga viti 2003-2007-2008, drejtorët i ka propozue kryetari, i ka zgjedhë Asambleja. Jo, me konkurs janë zgjedhë – më fal – jo kryetari, edhe ata kanë pas edhe kompetenca ekzekutive. Drejtorët, tash me ligj kryetari i zgjedh vetë. Unë e kam zgjedhë drejtor Beharin, si ekspert i mirë, edhe për mu është i mirë, edhe për mu punët në shëndetësi janë duke shkuar mirë. Nuk po them unë, po thojnë pacientët, po thotë popullata, që kemi një shërbim shëndetësor aty, i cili u ofron qytetarëve shërbime të nevojshme. Kemi eksperta, kemi një staf shëndetësor të përlqyeshëm. Nuk kam vërejtje fare. Por kemi pas vërejtje te menaxheri, tash është ndërrue menaxheri, është ndërrue edhe qasja e punëtorëve shëndetësorë ndaj pacientëve. Kështu që, pacientët janë shumë të kënaqur, edhe me investimet edhe me shërbimet. Unë të thashë kemi probleme me analiza, unë po e pranoj, është për keqardhje. Ju e akuzuat kryesuesen se pse s'po e qitni në diskutim Komisionin. Kryesuesja dje ka marrë pjesë në takimin e Qeverisë Komunale, dhe e ka dëgjue zyrtarin përgjegjës për këtë çështje, dhe kjo nuk e qet në propozim diçka që është kundërligjore. Kështu që, kjo ka pas të drejtë, po megjithatë unë nuk ia marrë të drejtën që nuk e ka qit, ajo është punë e kryesueses. Propozimet e Gllloboqicës që i përmendi. Asambleisti ka kërkue me të drejtë që të definohen emrat, edhe deri në shtator ata emra kanë me u definue. Ky nuk kërkoi që me u rrit shuma, ose me u zvogëlue, por vetëm kërkoi që ato mjete që janë nda për Gllloboqicë, me i orientue në projekte, edhe ato kanë me u orientue. Me pas lyp mjete shtesë, atëherë ky Kuvend votojke. U përmend nga z.Sejdilari, çdo herë ai po don me shkaktue përçamje, nxitje ndërnacionale, ndërnjerëzore të cilat i kemi të shkëlqyeshme me të dy komunitetet. Por, unë e di që as ju e as pozita nuk do ta lejojë një gjë të tillë.

Sepse ne, sa i përket buxhetit, çdo herë bëjmë diskriminim pozitiv. Qamili në seancën e kaluar ia ka përmend, s'po due me hy në polemika. Edhe tash kemi ndarë mjete nga komuniteti shqiptar për Dragash, që është investime të përbashkëta. Nuk më vjen mirë me i përmend diçka çka bëhet, por për hir të opinionit, për arsye se personi në fjalë do me bo përçamje, unë jam i obliguar si kryetar me i tregue që nuk është e vërtetë. Shpetim Hajredini tha që nuk jam i kënaqur me kubëzimet. Në kubëzim është mirë që janë ndarë mjetet. Tash ato nuk janë orientue kah kanë me shkue. Nëse nuk gjejmë forma tjera, kanë me shkue në rrugën kryesore. Ka mundësi edhe mjetet që i kemi paraparë për këtë vit me u ndreq një rrugë e gjatë që ish shumë, këndeje kah Kosava më duket diku, unë muj me e pru një vendim edhe për ato mos me shkue aty – nëse nuk na jep Qeveria – se kur ka mundësi me marrë prej dikujt, pse me i shpenzue mjetet tona. Këto janë çështje emergjente, është obligative Qeveria me i pague. Më dhatë vërejtje edhe sa i përket propozimit tim që për KAB-in përgjigjet të jepen pas votimit. Unë nuk muj me jua plotësue dëshirën e juaj që KAB-i mos me kalue. Unë e kam pru KAB-in këtu me kalue, jo me dështue. Kështu që, nuk dështoi, kaloi, ishalla edhe në shtator nuk dështon edhe shkojnë punët mirë. Edhe për kualitetin e punimebe, unë thashë 90% e atyre të anketuarve kanë thënë që jemi të kënaqur edhe me kualitetin. Po ju, nëse nuk jeni të kënaqur për atë 10 %-shin, nuk thashë qindpërqind, se gabojsha. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit kryetar, faleminderit për të gjithë! E mbylli këtë seancë!

Kryesuesja e Kuvendit

Arijeta Skeraj